



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

PLANI I VEPRIMIT TË PARTNERITETIT EVROPIAN 2012



Dhjetor 2011, Prishtinë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Plani i veprimit të Partneritetit Evropian 2012

Dhjetor 2011, Prishtinë

1. HYRJE	3
1.1. RAPORTET E REPUBLIKËS SË KOSOVËS ME BASHKIMIN EVROPIAN	3
2. PLANI I VEPRIMIT PËR IMPLEMENTIMIN E PARTNERITETIT EVROPIAN - AFRIMI I KOSOVËS ME BE-në	5
3. ZBATIMI I PVPE-së 2011 DHE ADRESIMI I SFIDAVE TË RAPORTIT TË PROGRESIT	7
3.1. KRITERET POLITIKE	7
3.1.1 DEMOKRACIA DHE SUNDIMI I LIGJIT	7
a. Institucionet	7
b. Administrata Publike.....	8
c. Sistemi gjyqësor	8
d. Politikat kundër korrupsionit	9
3.1.2 TË DREJTAT E NJERIUT DHE MBROJTJA E MINORITETEVE	9
3.1.3 ÇËSHTJET RAJONALE DHE OBLIGIMET NDËRKOMBËTARE	11
3.2 KRITERET EKONOMIKE	11
3.3. STANDARDET EVROPIANE	13
3.3.1. TREGU I BRENDSHËM	13
a. Lëvizja e lirë e mallrave	13
b. Lëvizja e lirë e kapitalit	15
c. Doganat dhe tatimet	15
d. Konkurrenca	16
e. Prokurimi publik	17
f. Të drejtat e pronësisë intelektuale	17
g. Punësimi dhe politikat sociale	18
h. Arsimi dhe kërkimet	19
3.3.2 POLITIKAT SEKTORIALE	20
a. Industria dhe NVM-të.....	20
b. Bujqësia dhe peshkataria	21
c. Mjedisi	23
d. Politikat e transportit	24
e. Energjia	25
f. Shoqëria informative dhe mediat	26
g. Kontrolli financiar	27
h. Statistikat	27
3.3.3. DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA	28
a. Vizat, kufijtë, azili dhe migrimi	28
b. Shpëlarja e parave	29
c. Drogat	29
d. Policia	29
e. Luftimi i krimit dhe krimit të organizuar	30
f. Mbrojtja e të dhënave personale	31
4. MATRICA E VEPRIME TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR PARTNERITET EUROPIAN 2011	32

1. HYRJE

1.1. RAPORTET E REPUBLIKËS SË KOSOVËS ME BASHKIMIN EVROPIAN

Kosova, sikur edhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, është pjesë e procesit të integrimit Evropian që nga *Samiti i Zagrebit* i vitit 2000 kur edhe filloi **Procesi i Stabilizim-Asociimit** (PSA) për Ballkanin Perëndimor. Ky proces synon stabilizimin dhe tranzicionin e përsheptuar të ekonomisë së tregut, promovimin e bashkëpunimit rajonal dhe perspektivën e integrimit në BE. Ky proces u konkretizua më tej në **Samitin e Selanikut** (qershor 2003) i cili e përfshiu edhe Kosovën në kornizën e **Procesit të Stabilizim-Asociimit**, kurse për Kosovën në veçanti kjo perspektivë u konkretizua më tej përmes Komunikatës së KE-së **‘E ardhmja evropiane për Kosovën’**, të datës 20 prill 2005, e cila tregon përkushtimin e Bashkimit Evropian për Kosovën.

Për të jetësuar Procesin e Stabilizim-Asociimit në Ballkanin Perëndimor, përfshirë edhe Kosovën, në qershor 2004 Këshilli Evropian miratoi **Partneritetin Evropian për Kosovën**, si instrumentin e parë që përcakton prioritetet kryesore afatshkurtra dhe afatmesme për tu adresuar nga institucionet e Kosovës drejt arritjes së perspektivës evropiane. Me qëllim të zbatimit të këtyre prioritetëve, në janar 2004 Qeveria e Kosovës miratoi **Planin e parë të Veprimit për implementimin e Partneritetit Evropian**. Që nga ai vit, ky dokument kryesor strategjik i Republikës së Kosovës për integrim në BE rishikohet çdo vit dhe implementimi i prioritetëve që parasheh është baza kryesore në rrugën e Kosovës drejt Bashkimit Evropian.

Që nga marsi i vitit 2003 deri në tetor të vitit 2009, instrumenti kryesor për dialog politik në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Komisionit Evropian në kuadër të kornizës së Procesit të Stabilizim-Asociimit ka qenë **“Mekanizmi i Procesit të Stabilizim-Asociimit”**. Në nëntor 2009, bazuar në Komunikatën e KE-së për Këshillin dhe Parlamentin Evropian **“Kosova – Përmbushja e perspektivës Evropiane”** ka avancuar procesin përmes lansimit të **Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit (DPSA)**, në kuadër të së cilit brenda një viti mbahet një Takim Plenar, tetë Takime Sektoriale (ose të Nën-komiteteve)¹, si dhe dy takime ‘horizontale’: Dialogu me Shoqërinë Civile dhe Komiteti i Përbashkët Monitorues (i cili shërben për monitorimin e implementimit të asistencës së BE-së). Përveç kësaj, mes tjerash Komunikata hap rrugën për fillimin e dialogut për liberalizim të vizave, nënshkrimin e një marrëveshjeje tregtare Kosovë – BE, zgjerim të Masave të Pavarura Tregtare dhe avancime në fushën e bashkëpunimit ndërkuftar.

Në anën tjetër, për të ndihmuar Kosovën në përmbushjen e perspektivës Evropiane, Bashkimi Evropian siguron **përkrahje financiare**, kryesisht për ndërtimin e institucioneve me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të tyre për përafrim me legjislacionin e BE-së *Acquis* dhe zbatim të standardeve evropiane, por gjithashtu me synim nxitjen e zhvillimit socio-ekonomik dhe avancimin e integrimit rajonal. BE-ja është **donatori më i madh i Kosovës**, i cili ndan më shumë resurse për kokë banori në Kosovë sesa në secilin vend të botës.

¹ 1) Drejtësia, Liria dhe Siguria, 2) Inovacioni, Shoqëria Informative, Politikat Sociale dhe Arsimit, 3) Tregtia, Industria, Doganat dhe Tatimet, 4) Tregu i Brendshëm, Konkurrenca dhe Mbrojtja e Shëndetit dhe Konsumatorëve, 5) Bujqësia, Peshkataria, Pylltaria, Siguria e Ushqimit, 6) Transporti, Mjedisi, Energjia dhe Zhvillimi Rajonal, 7) Ekonomia dhe Çështjet Financiare, Statistikat

Tabela 1: Shuma e asistencës financiare të BE-së për Kosovën (alokuar dhe planifikuar, për periudhën 2007 – 2012, në milionë €)

Komponentët	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Ndihma për Fazën Transitore dhe Ndërtimin e Institucioneve	68,3	184,7	106,1	66,1	66,9	68,2
Bashkëpunimi Ndërkufitar	0	0	0	1,2	1,8	1,8
TOTALI	68,3	184,7	106,1	67,3	68,7	70,0



Burimi: Ueb faqja zyrtare e Komisionit Evropian²

Kosova ka konfirmuar përkushtimin e saj për procesin e integrimit evropian përmes avancimit të mëtejshëm të kornizës institucionale, më e rëndësishmja nga të cilat ka qenë themelimi i Ministrisë së Integrimit Evropian. Në këtë drejtim Qeveria e Kosovës gjithashtu ka fuqizuar Zyrat për Integrim Evropian në institucionet e linjës përmes ngritjes së tyre në Departamente për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave si dhe ka funksionalizuar tutje strukturat për integrim evropian, me theks të veçantë në Grupet Punuese dhe Komitetin Punues për Integrim Evropian. Më tej Qeveria e Kosovës ka arritur të organizojë me sukses aktivitetet në kuadër të Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit dhe monitorimin e rekomandimeve të dala nga ky Dialog. Gjithashtu koordinimi në mes të Kuvendit dhe Qeverisë së Kosovës në fushën e integrimit evropian ka shënuar progres të theksuar gjatë vitit 2011.

Në aspekt të implementimit të PVPE 2011, në fushën kritereve politike ndër më të rëndësishmet që duhet të përmendet është progresi i shënuar në sferën e reformës së administratës publike ku është miratuar korniza e re ligjore dhe strategjike, por edhe në kuadër të reformës së sistemit gjyqësor, me theks të veçantë themelimi dhe funksionalizuar Këshillin Prokurorial të Kosovës. Është shënuar poashtu progres i mëtutjeshëm në përmirësimin e kornizës ligjore dhe institucionale për luftimin e korrupsionit, me theks të veçantë në miratimin e Ligjit për Financimin e Partive Politike dhe Ligjit për Konfliktin e Interesit si dhe atij të Prokurimit Publik. Progresi i konsiderueshëm është arritur gjithashtu edhe në procesin e decentralizimit në funksionalizimin e komunave të reja. Në fushën e bashkëpunimit rajonal, edhe pse me sfida e probleme të shumta, Kosova ka vazhduar me pjesëmarrjen e saj në nismat për bashkëpunim rajonal, kurse gjatë këtij viti Kosova ka marrë edhe kryesimin e radhës të CEFTA-së.

Në fushën e kritereve ekonomike, Qeveria e Kosovës ka vazhduar ruajtjen e stabilitetit makroekonomik përmes mbajtjes së politikave fiskale stabile, progresin e mëtutjeshëm në forcimin e ekonomisë së tregut dhe qëndrueshmërisë afatgjatë të

² http://ec.europa.eu/enlargement/potential-candidates/kosovo/financial-assistance/index_en.htm

financave publike, përfshirë rishikimin e KASH-it 2011-2014 dhe nënshkrimin e programit Staff Monitored Program me FMN-në. Qeveria poashtu ka aprovuar Vizionin për Zhvillim Ekonomik 2012-2014 dhe Planin përkatës implementues, dokumente keto që përmbajnë objektivat kryesore dhe prioritetet zhvillimore për këtë periudhë.

Autoritetet regullative gjithashtu kanë vazhduar kontributin në krijimin e parakushteve për një treg konkurrues përmes forcimit të mekanizmave rregullativ dhe rritjes së kapitalit human. Njëkohësisht, ka vazhduar procesi i reformës strukturore përmes privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe përmirësimit të qeverisjes korporatave të NP-ve.

Në fushën e standardeve evropiane, përfshirë këtu politikat sektoriale, Kosova ka vazhduar me afrimin e mëtutjeshëm me BE-në përmes harmonizimit të mëtutjeshëm të politikave dhe kornizës ligjore me standardet e BE-së. Në këtë sferë është shumë e rëndësishme të theksohet që Kosova ka shënuar progres të konsiderueshëm në fushën e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë. Me fokus në përmbushjen e kriterëve në kuadër të procesit të liberalizimit të vizave me BE-në, është kompletuar korniza ligjore dhe reformat institucionale të parapara deri më tani në fushën e vizave, kufijve, azilit dhe migrimit, përfshirë kornizën ligjore, të politikave dhe atë institucionale në fushën e riatdhesimit dhe ri-integrimit të personave të riatdhesuar, e cila paraqet një fushë prioritare në këtë sektor. Gjithashtu është shënuar progres në përmirësimin e kornizës ligjore dhe ndërtimin e reformimit institucional në fushën e Policisë dhe me qëllim të luftimit të të gjitha llojeve të krimit, por edhe në atë të mbrojtjes së të dhënave personale.

Megjithatë, Kosova vazhdon të ballafaqohet me sfida të shumta në fushat e lartpërmendura dhe ky Plan parasheh veprime konkrete për adresimin e tyre, veprime të cilët janë të përciellur me indikator matës të cilët do të mundësojnë monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të Planit.

2. PLANI I VEPRIMIT PËR IMPLEMENTIMIN E PARTNERITETIT EVROPIAN - AFRIMI I KOSOVËS ME BE-në

Meqenëse Integrimi Evropian mbetet prioriteti kryesor i Qeverisë së Kosovës, Plani i Veprimit i Partneritetit Evropian është dokumenti kryesor afatmesëm planifikues, i cili ka për qëllim adresimin e sfidave dhe prioritetëve kyçe afatshkurta dhe afatmesme të identifikuar nga Partneriteti Evropian 2008.³ Përparimi i mëtutjeshëm i vendit do të matet në bazë të zbatimit të prioritetëve kyçe, afatshkurta dhe afatmesme, në kuadër të Partneritetit Evropian përmes Raportit të përvitshëm të Progresit nga Komisioni Evropian. Në këtë kontekst, PVPE-ja duhet të përdoret për planifikimin e veprimtarisë së përgjithshme të Qeverisë në lidhje me agjendën politike dhe prioritetet e saj, agjendën legjislative të Qeverisë dhe të Kuvendit, nevojat për punësim, ndërtimin institucional dhe trajnimin e personelit si dhe investimet e nevojshme.

³ Prioritetet e Partneritetit Evropian janë ndarë në prioritete afatshkurtra (1-2 vite) dhe prioritete afatmesme (3-4 vjet). Prioritetet afatshkurtra - përshkruajnë veprimet që do të zbatohen vis-a-vis prioritetëve afatshkurtra brenda secilës fushë, kurse prioritetet afatmesme - përshkruajnë veprimet që do të zbatohen vis-a-vis prioritetëve afatmesme brenda secilës fushë.

Gjithashtu, PVPE-ja duhet të përdoret për komunikim të brendshëm të Qeverisë me qëllim të harmonizimit të objektivave, veprimeve dhe afateve brenda saj; për komunikim mes Qeverisë dhe komunitetit afarist dhe partnerëve social si mekanizëm informues dhe paralajmërues për ndryshimet që do të ndodhin dhe të cilat prekin ato; për komunikim me shoqërinë civile si bazë për ndërtimin e partneritetit; dhe për komunikim me publikun e gjerë në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar në çdo kohë për punën e Qeverisë në procesin e integritimit evropian.

Plani ndjek strukturën e Partneritetit Evropian për Kosovën 2008 si dhe është në pajtim me kriteret e Kopenhagës dhe Madridit dhe përmban tre kapituj kryesor: **Kriteret Politike, Kriteret Ekonomike dhe Standardet Evropiane**. Në secilin kapitull, varësisht nga progresi i arritur në ato fusha dhe nevojat për përmirësimin e situatës në të ardhmen, janë paraparë veprime të cilat kanë të bëjnë me sigurimin dhe përmirësimin e politikave strategjike dhe legjislacionit, respektivisht harmonizimin e mëtutjeshëm të kornizës ligjore vendore me *Acquis*, hartimin dhe miratimin e legjislacionit të ri të nevojshëm dhe veprime të cilat fokusohen në implementimin e legjislacionit në fuqi, reformën institucionale, zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, investimet kapitale, etj.

PVPE 2012 ka gjithsej 261 veprime, prej tyre 62 veprime janë paraparë në fushën e kriterëve politike, 32 veprime në fushën e kriterëve ekonomike dhe 167 për standardet evropiane. Me qëllim që PVPE-ja të jetë një dokument më i matshëm dhe më praktik, këtë vit janë përcaktuar edhe indikatorët matës në nivel të veprimeve.. Vlen të theksohet se është shënuar progres në përlllogartijen e kostos së PVPE 2012 dhe lidhjen e tij me buxhetin. Kostoja e totale e PVPE 2012 është vlerësuar të jetë rreth 826,557,499 €, ku 764,559,173 € planfikohet të mbulohen nga BKK, 54,156,416 € planfikohet të mbulohen nga donatorët, ndërsa 7,841,909 € është vlerësuar të jetë mungesa (zbrazëtira).

Duke pasur parasysh rëndësinë prioritare të Planit të Veprimit të Partneritetit Evropian, si një dokument kryesor mbarë qeveritar për integrim evropian, rishikimi i këtij plani ka marrë parasysh prioritetet e Qeverisë dhe programin e saj, draft buxhetin 2012, Kornizën Afat-mesme të Shpenzimeve, Strategjitë e ndryshme sektoriale dhe planet e tyre të veprimit, rekomandimet dhe sfidat e dala nga Raporti të Progresit të Komisionit Evropian si dhe ato nga Dialogu i Procesit të Stabilizim Asociimit. Me qëllim të monitorimit dhe të adresimit të duhur të rekomandimeve në fjalë, gjatë vitit 2012, Qeveria e Kosovës parashihet veprime konkrete për adresimin e tyre dhe do t'i përfshijë ato në Sistemin për Monitorimin dhe Raportimin e PVPE.

Për të ruajtur koherencën e adresimit të prioriteteve të dala nga dokumente të ndryshme të Bashkimit Evropian për Kosovën, gjatë rishikimit të PVPE Qeveria e Kosovës ka paraparë veprime të cilat marrin parasysh të gjitha prioritetet që dalin nga procesi i integritimit evropian. Gjatë procesit të rishikimit është vërejtur që një numër i prioriteteve, apo pjesë të tyre, janë realizuar dhe tani më mund të llogariten si prioritete të vjetruara. Prandaj në fusha të caktuara janë paraparë veprime të cilat nuk adresojnë drejtpërdrejtë prioritetet e Partneritetit Evropian, por të cilat veprime adresojnë sfida të caktuara që janë identifikuar nga Raporti i Progresit apo Dialogu i Procesit të Stabilizim-Asociimit. Gjithashtu mund të vrehen prioritete për të cilat nuk janë paraparë fare veprime për arsye se ato prioritete tani më janë të realizuara apo të cilat brenda kornizës së përgjithshme të prioriteteve që dalin nga procesi i integritimit

evropian të Kosovës janë më pak relevante apo janë adresuar në prioritetet të tjera afatshkurta ose afatmesme. Prandaj, duhet të theksohet rëndësia e nevojës për rifreskimin e prioriteteve të Partneritetit Evropian dhe këte me qëllim të ruajtjes së koherencës së prioriteteve të BE-së për Kosovën dhe si rezultat edhe planifikimit më koherent të Kosovës për adresimin e tyre.

Sa i përket monitorimit të implementimit të Planit të Veprimit të Partneritetit Evropian, Ministria e Integritimit Evropian gjatë vitit 2010 ka lansuar dhe funksionalizuar sistemin elektronik për monitorim dhe raportim të PVPE-së. Gjatë 2011 ky sistem është shfrytëzuar për përpilimin e raporteve në baza tremujore nga secili institucion bartës i veprimeve konkrete në kuadër të PVPE 2010 dhe PVPE 2011. I njëjti sistem do të përdoret edhe gjatë vitit 2012 për monitorimin e implementimit të PVPE si dhe për monitorimin e implementimit të rekomandimeve të dala nga Dialogu i Procesit të Stabilizim Asociimit.

Grupet Punuese për integrim evropian, përkundër vështirësive të mëdha, kanë luajtur rol të rëndësishëm në procesin e përpilimit, monitorimit dhe rishikimit të këtij plani. Në përmirësimin e performancës dhe efektivitetin tyre kanë ndikuar ndjeshëm procesi i rishikimit funksional të Grupeve punuese, Manuali Operativ dhe trajnimet në përdorimin e tij, procese dhe dokumente të nxjerra nga ana e Ministrisë së Integritimit Evropian . Duhet theksuar se procesi i harmonizimit përmbajtësor i Grupeve Punuese me strukturën e takimeve të DPSA-së, është në fazën përmbyllëse. Ky Harmonizim bëhet me qëllim të rritjes së efektivitetit dhe kontributit të këtyre grupeve punuese në procesin e implementimit të prioriteteve të Bashkimit Evropian për Kosovën.

3. ZBATIMI I PVPE-së 2011 DHE ADRESIMI I SFIDAVE TË RAPORTIT TË PROGRESIT

3.1. KRITERET POLITIKE

3.1.1 DEMOKRACIA DHE SUNDIMI I LIGJIT

a. Institucionet

Forcimi i institucioneve bazë për sigurimin e demokracisë dhe sundimit të ligjit edhe gjatë vitit 2011 ka mbetur prioritet i të gjithë institucioneve të Republikës së Kosovës. Pas zhvillimit të zgjedhjeve parlamentare dhe ri-votimit në një numër komunash Kuvendi i ri u konstituua në shkurt 2011. Gjatë kësaj kohe është shënuar një dinamizim i bashkëpunimit në mes Komisionit për Integrim Evropian dhe MIE-së. Gjithashtu, Kuvendi me sukses ka implementuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe ka miratuar një numër ligjesh.

Gjatë vitit 2011 Qeveria ka vazhduar me forcimin e kapaciteteve të saja duke përforcuar strukturat koordinuese , përfshirë këtu krijimin e DIEKP-ve por edhe duke asistuar nivelin komunal duke miratuar rregulloren për Zyrat për Integrim Evropian në komuna. P/r më tepër, ka vazhduar forcimi edhe i qeverisjes lokale përmes Planit Strategjik për zhvillimin e kapaciteteve komunale, si dhe përmes mekanizmit për kontrollin e ligjshmërisë së akteve komunale.

Përkundër progresit të shënuar, mbetin ende sfida në këtë sektor, sidomos në forcimin e mëtejme të kapaciteteve administrative të Kuvendit dhe Qeverisë, veçmas

në drejtim të përfshirjes së mëtejme të agjendës së integritetit evropian. Në kontekstin e ngritjes së kapaciteteve, sfidë e veçant mbetet filtrimi i legjislacionit nacional në raport me *acquis communautaire*.

Në drejtim të adresimit të këtyre sfidave, përmes këtij Plani planifikohet të merren masa për përmirësimin e mbikëqyrjes së ekzekutivit nga ana e Kuvendit, ngritjes së kapaciteteve administrative si nga Kuvendi ashtu edhe Qeveria dhe veçmas në drejtim të harmonizimit të legjislacionit nacional në me *acquis communautaire*, si dhe në drejtim të koordinimit më të përshtatshëm të politik-bërjes dhe legjislacionit në vend (Prioriteti 12)

b. Administrata Publike

Gjatë vitit 2011, reforma e administratës publike ka vazhduar të mbetet prioritet kyç i Qeverisë. Prandaj Qeveria ka vazhduar me miratimin e legjislacionit sekondar për implementimin e legjislacionit bazik të shërbimit civil, si dhe ka miratuar një numër Planesh Zhvillimore Strategjike, rezultate të rishikimit funksional.

MAP ka marrë përgjegjësi edhe në monitorimin e implementimit të Planeve Zhvillimore Strategjike, sikurse edhe në monitorimin e vendimeve të KNRAP.

Përkundër masave të ndërmarra, mjaft sfida mbeten në këtë sektor e sidomos në drejtim të implementimit të legjislacionit të ri për shërbim civil, avancimit të sistemit të menaxhimit të resurseve njerëzore, implementimin e Strategjisë së Reformës së Administratës Publike si dhe në implementimin e rishikimit funksional.

Me qëllim të adresimit të këtyre sfidave të mbetura, plani i tanishëm parasheh masa të mëtejme ligjore dhe të ndërtimit të kapaciteteve si në drejtim të implementimit të legjislacionit kornizë për shërbimin civil, përmirësimin të menaxhimit të resurseve njerëzore, implementimit të Strategjisë së Reformës së Administratës Publike dhe rekomandimeve të rishikimit funksional për të gjitha institucionet si dhe për përmirësimin e sistemit të integruar të politikave (Prioriteti 19-22).

c. Sistemi gjyqësor

Një sistem gjyqësor efikas dhe i pavarur paraqet një ndër kushtet kryesore në drejtim të sigurimit të sundimit të ligjit. Kosova ka shënuar progres të rëndësishëm në reformimin e sistemit të saj gjyqësor gjatë vitit 2011 përmes vazhdimin të kompletimit të kornizës ligjore për gjykata dhe prokurori, si dhe përmes kompletimit të kornizës institucionale, duke themeluar dhe funksionalizuar Këshillin Prokurorial të Kosovës. Gjithashtu, progres është arritur edhe në zhvillimin e legjislacionit për përgjegjësinë e personave juridikë, për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunim juridik ndërkombëtar.

Sukses është arritur edhe në fushën e reduktimit të lëndëve të pazgjidhura (26% për vitin 2011, përmes themelimit të një zyre për ekzekutimin e lëndëve dhe rekrutimit të rreth 30 zyrtarëve për këtë qëllim. Gjithashtu, në këtë drejtim hap i rëndësishëm është ndërmarrë në zhvillimin e mëtejme të sistemit të ndërmjetësimit dhe noterisë, duke licencuar rreth 50 ndërmjetës dhe 10 noterë.

Me gjithë progresin e shënuar, mbetet një numër jo i vogël sfidash në këtë sektor, përfshirë në drejtim të sigurimit të implementimit të legjislacionit të miratuar, planifikimit zhvillimor në kuadër të reformës së gjyqësorit, ngritjes së kapacitetit menaxhues të këtij sektori, dhe rritjes së efektshmërisë për të zvogëluar numrin e rasteve të grumbulluara.

Me qëllim të adresimit të këtyre sfidave, ky Plan Veprimi, parasheh që masat të ndërmerren në drejtim të kompletimit të kornizës ligjore me miratimin e Kodit Penal dhe atij të Procedurës Penale, implementimit në gjykata dhe prokurori përmes ristrukturimit të tyre, edhe ngritjes së mëtejme të kapaciteteve në këto institucione. Ky plan parasheh gjithashtu, edhe përmirësimin e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar përmes avancimit të legjislacionit përkatës, sikurse edhe bashkëpunimin ndër-institucional dhe përmirësimin e infrastrukturës për gjykata dhe prokurori (Prioritetet 23-27).

d. Politikat kundër korrupsionit

Luftimi i korrupsionit edhe gjatë vitit 2011 ka mbetur lartë në listën e prioriteteve të Qeverisë së Kosovës dhe institucioneve tjera. Kështu, gjatë kësaj kohe është përmirësuar korniza ligjore në këtë fushë përmes miratimit të Ligjit për Financimin e Partive Politike, Ligjit për Konfliktin e Interesit si dhe atij për Prokurim Publik. Gjatë kësaj kohe është bërë deklarimi i pasurisë së zyrtarëve të lartë publik duke bërë publikimin e këtyre deklaratave në ueb-faqen zyrtare të Agjencisë, përderisa janë nisur procedurat adekuate kundër atyre që nuk kanë deklaruar pasurinë. Gjithashtu, janë caktuar prokurorë të veçantë anti-korrupsion në prokuroritë e qarkut.

Megjithatë, mbetet një numër i konsiderueshëm sfidash në këtë sektor, si në drejtim të përmirësimit të mëtejme të legjislacionit, rritjes së shkallës së kapaciteteve institucionale dhe bashkëpunimit ndër-institucional, sikurse edhe promovimin e politikave sektoriale parandaluese në luftimin e korrupsionit.

Me qëllim të adresimit të këtyre sfidave, ky Plan Veprimi parasheh, përmirësime në implementimin e kornizës ligjore. Për më tepër ky Plan parasheh edhe masa në drejtim të plotësimit të kornizës së politikave përmes vënies në funksion të një qasjeje sektoriale për parandalim dhe luftim të korrupsionit, si dhe ngritjes së vetëdijesimit kundër këtij fenomeni përmes krijimit të një mekanizmi që përcjellë rastet e korrupsionit. Në linjë me këtë, Plani përmban edhe masa që planifikohet të ndërmerren në drejtim të rritjes së shkallës së bashkëpunimit ndër-institucional në luftimin e korrupsionit si dhe masa për përgatitjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve në këtë drejtim (Prioritetet 34, 111-112).

3.1.2 TË DREJTAT E NJERIUT DHE MBROJTJA E MINORITETEVE

Përgjatë vitit 2011, institucionet e ndryshme kanë treguar shkallë më të lartë angazhimi drejt respektimit të të drejtave të njeriut. Kështu, edhe më tej është në proces e sipër përmirësimi i kornizës ligjore për liritë fetare si dhe legjislacioni për lirinë e shprehjes.

Gjithashtu, ka pasur përmirësime në kornizën institucionale përmes themelimit të Koordinatorin Kombëtarë për të drejtat pronësore dhe themelimit të Komisionit për Drejtësinë për të Mitur. Kushtet në sistemin e burgjeve vazhdojnë të shënojnë përmirësime, Gjithashtu, janë hapur zyrat shtesë për ndihmë juridike, kurse është miratuar edhe legjislacioni i ri për lirinë e mbledhjes dhe asociimit në OJQ.

Edhe pas gjithë këtij angazhimi, mbeten një numër sfidash në këtë sektor, e sidomos për sa i përket qasjes në drejtësi të viktimave, kushteve në burgje, qasjes në dokumente zyrtarë, gjetjes së një modeli financimi për RTK-në, implementimit të kornizës ligjore dhe të politikave për liritë civile sikurse edhe për respektimin e të drejtës mbi pronë. Gjithashtu, mbetet edhe një numër i konsiderueshëm sfidash në drejtim të implementimit të legjislacionit që rregullon marrëdhëniet e punës sikurse edhe skemat sociale.

Me qëllim të adresimit të një numri sa më të madh të sfidave në këtë sektor, Plani i tanishëm parasheh një numër masash, posaçërisht përmes përmirësimit të kornizës ligjore për të drejtat e njeriut duke paraparë miratimin e legjislacionit që rregullon funksionimin e mekanizmave për të drejtat e njeriut, legjislacionin për personat e pagjetur, financimin e qëndrueshëm të RTK-në, barazinë gjinore si dhe liritë fetare. Më tej, ky plan parasheh përmirësimin e implementimit të kornizës së politikave në fushën e të drejtave të njeriut përmes masave që kanë të bëjnë me zbatimin e Strategjisë për të Drejtat e Njeriut, atë për Personat me Aftësi të Kufizuara si dhe të Strategjisë për të Drejtat e Fëmijëve.

Gjithashtu, parashihet edhe përmirësimi i funksionimit të mekanizmave institucionale në këtë fushë përmes ristrukturimit të strukturave që merren me të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e minoriteteve, funksionalizimit të mekanizmave që merren me implementimin rekomandimet e Avokatit të Popullit, sikurse edhe masa tjera që do të ndikonin në forcimin e kapaciteteve institucionale në drejtim të respektimit të barazisë gjinore, respektimit të të drejtave të fëmijëve si dhe në implementimin e skemave sociale. Duke pas parasysh rëndësinë e participimit të një numri sa më të madh institucionesh dhe qytetarësh në drejtim të përmirësimit të respektimit të të drejtave të njeriut, ky Plan parasheh masa vetëdijësuese sidomos sa i përket implementimit të Ligjit kundër Diskriminimit, si dhe barazisë gjinore dhe luftimit të dhunës në familje (Prioritetet 36-43).

Mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të minoriteteve

Viti 2011 ka shënuar progres në drejtim të respektimit të të drejtave të minoriteteve përmes zhvillimit të suksesshëm të procesit të decentralizimit për të krijuar kushte për një ambient më të përshtatshëm për kthim. Vlerësohet lartë si nga Qeveria ashtu edhe partnerët tjerë, ulja e numrit të incidenteve ndër-etnike.

Përmirësimi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore është arrit përmes avancimit të kornizës institucionale, emërimit të Drejtorit të Departamentit për Trashëgimi Kulturore dhe miratimit të Strategjisë për Konservim të Integruar.

Gjatë vitit janë kthyer 2261 pjesëtarë të komunitetit pakicë, përderisa është mbyllur kampi në Cesmin Lug, kurse ai në Osterode është në proces e sipër. Duhet cekur se procesi i implementimit të kurrikulës në gjuhën rome ka filluar

Me gjithë angazhimin e treguar, mbetet një numër sfidash si në drejtim të rritjen e kapaciteteve për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore poashtu në drejtim të përmirësimit të harmonizimit të institucioneve relevante që merren me çështjet e komuniteteve, por edhe në fushën e përdorimit të gjuhëve. Problemet rëndohen edhe më shumë nga situata jo e përshtatshme ekonomike, sidomos për pjesëtarët e komunitetit RAE, sikurse edhe nga sfidat në ri-integrimin e tyre si në kuadër të procesit të kthimit vullnetar dhe atij të detyruar. Sfidë shtesë paraqet edhe konsolidimi i kornizës strategjike për rregullimin e vendbanimeve joformale.

Me qëllim të adresimit të disa prej këtyre sfidave, ky Plan Veprimi parasheh masa në drejtim të rritjes së numrit të pjesëtarëve jo-shumicë në të gjitha nivelet institucionale, rritjen e qasjes në arsimim si dhe në shërbimet shëndetësore. Gjithashtu, parashihen masa për përmirësimin e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore si dhe përdorimit të gjuhëve. Për më shumë, janë planifikuar edhe masa shtesë për rregullimin e vendbanimeve jo-formale si dhe për implementimin e kornizës ligjore dhe strategjike për kthim vullnetar (Prioritetet 44-47).

3.1.3 ÇËSHTJET RAJONALE DHE OBLIGIMET NDËRKOMBËTARE

Progresi i shënuar në kuadër të bashkëpunimit rajonal konsiston kryesisht në pjesëmarrjen e Kosovës në nismat për bashkëpunim rajonal, siç është Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, si dhe Takimi i Nivelit të Lartë BE – Ballkan Perëndimor. Për më tepër, Kosova vazhdon të përfshihet në të gjitha obligimet që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë, Marrëveshja për Hapësirën për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore (CEFTA), Marrëveshja mbi Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ECAA), Observatorin e Transportit për Evropën Juglindore (SEETO).

Përderisa Kosova ka kryesuar CEFTA-në gjatë këtij viti, pa vështirësi të mëdha, sfidë mbetet përfshirja e plotë në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal (RCC) megjithëse vazhdon të përfshihet në aktivitetet e tyre, barriera të natyrës politike (për shkak të mosnjohjes nga një numër i vogël shtetesh fqinje) vazhdojnë të pengojnë seriozisht që Kosova të jetë pjesë e barabartë dhe të përfitojë nga RCC. Gjithashtu ka vazhduar përfshirja, në rolin e vëzhguesit, në Kompaktin për Investime për Evropën Juglindore, e cila është projektuar për të përmirësuar klimën e investimeve dhe për të inkurajuar zhvillimin e sektorit privat në rajon.

Për adresimin e sfidave në këtë fushë, Plani parasheh aktivitete që kanë të bëjnë me kompletimin e kornizës strategjike për bashkëpunim rajonal si dhe masa për vendosjen e kornizës ligjore, strategjike dhe institucionale që mbulon fushat kyçe sektoriale me relevancë në bashkëpunimin rajonal: tregtinë, energjinë, aviacionin civil, bashkëpunimin ndër-kufitar dhe administratën publike (Prioritetet 48-49).

3.2 KRITERET EKONOMIKE

Në funksion të forcimit të ekonomisë së tregut, Qeveria ka vazhduar të ketë si prioritet stabilitetin makroekonomik dhe ndërveprimin e forcave të tregut edhe gjatë vitit 2011. Në këtë drejtim, Qeveria ka aprovuar Kornizën e rishikuar Afatmesme të Shpenzimeve 2012-2014 dhe ka aprovuar Vizionin për Zhvillim Ekonomik 2011-2014

dhe Planin përkatës implementues, dokumente keto që përmbajnë objektivat kryesore dhe prioritetet zhvillimore për këtë periudhë.

Institucionet përkatëse kanë punuar në drejtim të mbajtjes së politikave fiskale stabile dhe qëndrueshmërisë afatgjate të financave publike. Në këtë kuadër, në qershor 2011, qeveria ka nënshkruar me FMN programin e ri "Staff Monitoring Program" dhe janë përmbushur dy veprimet paraprake të përcaktuara me këtë marrëveshje.⁴ Po ashtu, Qeveria ka plotësuar kriteret e matshme duke mbajtur bilancin bankar në fund të Shtatorit brenda nivelit të përcaktuar me program. Gjithashtu, niveli i shpenzimeve ka qenë më i ulët dhe suficiti primar ka rezultuar të jetë më i lartë se ai që është paraqitur si kriter i matshëm. Qeveria po ashtu ka arritur të plotësoj zotimin e saj ndaj programit duke marrë vendimin për aplikimin e akcizës në lojëra të fatit dhe lejimin e importimit të veturave me të vjetra se 8 vite. Ky vendim ka filluar te zbatohet nga 1 Korriku i vitit 2011. Janë vazhduar edhe konsultimet e rregullta në kuadër të Mekanizmit të Mbikëqyrjes Fiskale me Komisionin Evropian, mekanizëm ky i cili e analizon dhe shqyrton të gjitha politikat me ndikim fiskal.

Procesi i privatizimit ka vazhduar si dhe kontributi për të forcuar mekanizmat për përmirësimin e qeverisjes dhe qëndrueshmërisë financiare të NP-ve. Me qëllim të përsheptimit të procesit të likuidimit dhe riorganizimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, janë aprovuar Ligji për AKP-në dhe Ligji për Ndërmarrje të Veçanta. Janë mbajtur disa vale të privatizimit, rundi i 7 i likuidimit të ndërmarrjeve në pronësi shoqërore si dhe ka vazhduar shpërndarja e 20% të mjeteve punëtoreve nga shitja e ndërmarrjeve.

Në funksion të përmirësimit të qeverisjes korporative të NP-ve dhe përsheptimit të reformës strukturale, Këshilli Ndërmnistror për Privatizimin e KEDS ka aprovuar para-kualifikimin e tri kompanive (prill 2011) dhe Kërkesën për Propozim (gusht 2011) për të lejuar ofertimin e këtyre kompanive.

Me qëllim të rritjes së aftësisë konkurruese në treg dhe promovimit të ambientit të favorshëm për biznes, ka vazhduar puna për forcimin e të drejtave pronësore. Në këtë drejtim, është kompletuar infrastruktura e nevojshme ligjore për të gjitha fazat e ndërmjetësimit përfshirë rregulloren për licencimin e ndërmjetësuesve (Korrik 2011). Poashtu është aprovuar dokumenti i Rregullave të Arbitrazhit. Autoritetet rregullative kanë shënuar progres në drejtim të ngritjes dhe zgjerimit të kapitalit njerëzor përmes trajnimeve dhe avancimit profesional. Që nga Janari 2011 ka filluar implementimi i veprimeve të Strategjive të Punësimit ashtu siç është e parapare në Planin e Veprimit. Janë krijuar mekanizmat e nevojshëm për monitorimin e implementimit të Planit, duke përfshirë Grupin Drejtues të Strategjisë dhe Grupin për Zhvillimin dhe Monitorimin e Planit Veprues të Strategjisë (Maj 2011).

Përparim është shënuar në forcimin e mekanizmave rregullativ në funksion të tregut dhe konkurrencës përfshirë këtu edhe plotësimin e rregullativës tarifore dhe përmirësimin e performancës.

⁴ Shpërndarja e komitetit për shqyrtimin e kriterëve për beneficione për të gjitha kategoritë e dala nga lufta, dhe stopimin e numrit të përfituesve i cili duhet të korrespondojë me nivelin/numrin deri në fund të Majit-2011, duke përfshirë këtu numrin e aplikacioneve të pranuar deri më datën e lartcekur dhe aprovimin e aktin nën-ligjor për 'Ligjin për të drejtat e të përndjekurve politikë zyrtarë dhe personat e përndjekur' që përcakton se përfitimet e paguara me këtë ligj duhet të paguhet vetëm nga fondet që në mënyrë eksplicite dhe specifike janë krijuar për këto qëllime me ligjin mbi buxhetin.

Në fushën e arsimit, ka vazhduar procesi i akreditimit dhe licencimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe është bërë klasifikimi i niveleve në pajtueshmëri me kornizën e kualifikimeve evropiane.

Nga aspekti i kapitalit fizik, qeveria ka vazhduar me investimet në infrastrukturën rrugore ku po vazhdon ndërtimi i autostradës Morinë-Merdar ku janë lëshuar në qarkullim 38 km e parë, si dhe zgjerimi i rrugëve M2 dhe M9.

Përveç progresit të arritur në forcimin e ekonomisë së tregut dhe stabilitetit makroekonomik dhe ndikimit të limituar të krizës financiare botërore në Kosovë, mbetet sfida forcimi i lidhjes në mes të politikave prioritare, reformave strukturale dhe shpenzimeve publike. Për më tepër, zvogëlimi i disbalancit të jashtëm dhe papunësisë mbeten sfida komplekse që ndër lidhen edhe me rritjen e konkurrueshmërisë dhe të avancimit të mëtutjeshëm të kapitalit njerëzor.

Zhvillimi i mëtutjeshëm i kornizës ligjore dhe zbatimi i ligjeve mbetet sfida sidomos në fushën e të drejtave pronësore dhe kontratave, me ndikim në përmirësimin e ambientit për biznes. Në kuadër të strukturës sektoriale dhe të ndërmarrjeve, sfidat konsistojnë në ndryshimin e kësaj strukture që përbëhet në pjesë të madhe nga ndërmarrjet e vogla, dhe në zvogëlimin e informalitetit në ekonomi.

Me qëllim të adresimit të këtyre sfidave, Plani 2012 përmes aktiviteteve të planifikuara, synon të adresojë stabilitetin e financave publike e politikave fiskale, përmirësimin e qeverisjes dhe rritjen e efikasitetit të NP-ve. Plani gjithashtu përfshin vazhdimësinë e procesit të privatizimit me fokus të veçantë në forcimin e qeverisjes dhe reduktimin e ndihmave në sektorin publik. Pjesë e realizimit të këtij qëllimi është edhe privatizimi i PTK-së dhe Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, aktivitete të përfshira në Planin e veprimit për vitin 2012. Në sektorin financiar parashihet avancimi i mëtejme legjislativ i institucioneve mikrofinanciare.

Në funksion të përmirësimit të ambientit për biznes dhe rritjes së konkurrueshmërisë, Plani përmban adresimin e sfidave për forcimin e të drejtave pronësore, politikat për krijimin e një tregu funksional të punës dhe rritjes së kualitetit e kuantitetit të kapitalit njerëzor si dhe përmirësimin e kapaciteteve eksportuese (Prioritetet 50-54 dhe 120-124).

3.3. STANDARDET EVROPIANE

3.3.1. TREGU I BRENDSHËM

a. Lëvizja e lirë e mallrave

Në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave gradualisht janë duke u krijuar kushte me të mira për tregti, industri dhe shërbime. Përpilimi i politikave të punës dhe zbatimi i legjislacionit për përkrahjen e konkurrueshmërisë korrekte dhe të pronësisë intelektuale, përpjekjet për hartimin e programeve dhe legjislacionit në përkrahjen e ndërmarrjeve industriale, tregtare, turistike si dhe politikave zhvillimore të sektorit privat, po e ndihmojnë dukshëm arritjen e standardeve evropiane në këtë fushë. Kapacitetet

njerëzore të profilizuara mirë dhe niveli i lartë i investimeve e bëjnë këtë fushë një sfidë për çdo qeveri pra edhe për Qeverinë e Kosovës.

Në kuadër të Infrastrukturës së Cilësisë është arritur që të zgjerohet korniza ligjore. Në fushën e *metrologjisë* është paraparë përmirësimi i mëtutjeshëm i legjislacionit primar⁵ dhe atij sekondar si dhe funksionalizimi i Laboratorit Qendror të Metrologjisë së Kosovës (LQMK).⁶

Ngritja e menaxhimit të sistemit të cilësisë do të bëhet nëpërmes të përgatitjes së laboratorëve për akreditim si dhe në mirëmbajtjen, kalibrimin e etalonëve në laboratorët ekzistuese për masë, vëllim dhe rrjedhe, temperaturë, elektrikë. Tani më Drejtoria e Kosovës për *Akreditim* (DAK) është anëtarësuar në dy organizata rajonale dhe ndërkombëtare (IAF dhe ILAC) si dhe është bërë anëtare me kontratë në Korporatën Evropiane të Akreditimit.

Disa nga sfidat e *industrisë* nga e kaluara vazhdojnë të mbesin të tilla edhe sot , si: baza e të dhënave për kompanitë industriale, përfundimi i laboratorit për përmirësimin e kualitetit të produkteve, hartimi i kurrikulit për trajnimin e menaxherëve lidhur me përmirësimin e kualitetit të produkteve dhe implementimi i rregullores për autorizimin e Trupave për Vlerësim të Konformitetit.

Miratimi i Ligjit për Inspektoratin e Tregut ka përmirësuar kornizën ligjore për mbikëqyrjen e tregut, kurse tani rëndësi e veçantë do t'i kushtohet aprovimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Inspektoratin e Tregut dhe Mbrojtjen e Konsumatorëve. Kompletimi i legjislacionit sekondar në fushën e mbikëqyrjes së tregut shihet si një prioritet për këtë fushë. Në vitin 2012 parashihet që të draftohen dhe të miratohen disa Udhëzime Administrative. Programi për Mbrojtjen e Konsumatorit 2010- 2014 gradualisht ka filluar që të zbatohet duke mbajtur takime publike si dhe me publikimin e fletëpalosjeve të ndryshme e me qëllim të informimit të publikut lidhur me rëndësinë e mbrojtjes së konsumatorit.

Krijimi i Standardeve për Njësitë akomoduese dhe Agjencitë Turistike shihet si prioritet në fushën e *turizmit*. Kjo parashihet të arrihet përmes ngritjes së standardit të njërive akomoduese në gjithë Kosovën, si dhe në kompletimin e Softuerit për klasifikimin dhe kategorizimin në bazë të UA "Për Klasifikim dhe Kategorizim të Objekteve Hoteliere"

Përkundër një varg të të arriturash, infrastruktura e cilësisë ka para veches shumë sfida. Sfidë kryesore për Departamentin e Metrologjisë mbetet anëtarësimi në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të metrologjisë, kjo kërkon që në të ardhmen të punohet në drejtim të zhvillimit të metrologjisë industriale. Fusha e standardizimit edhe më tej vazhdon të sfidohet në pamundësinë e anëtarësimit në ISO për arsye se kjo kushtëzohet me anëtarësimin e Kosovës në OKB. Drejtoria e Akreditimit për të zgjeruar aktivitetin e saj ka nevojë të rris numrin e Trupave për Vlerësimin e Konformitetit. Inspektorati i Tregut sfidë për të ardhmen vazhdon të ketë zbatimin e Ligjit të ri për Inspektoratin e Tregut të shoqëruar me legjislacionin

⁵ Amandamenti i Ligjit për Metrologji Nr.03/L-203. Njëkohësisht është vazhduar me zbatimin e Strategjisë për Zhvillimin e Infrastrukturës së Metrologjisë

⁶ Laboratori për madhësi elektrike i pajisur me etalon (me qëllim të matjes së energjisë elektrike), laborator i masës dhe laborator i temperaturës.

sekondar të fushës, si dhe me nevojën për implementimin e Strategjisë për Mbikëqyrjen e Tregut. Njëkohësisht, në drejtim të mbikëqyrjes së tregut do të vazhdohet të punohet në zbatimin e plotë të Programit për Mbrojtjen e Konsumatorit 2010-2014.

Në fushën e tregtisë, tanimë pas shfrytëzimit të masave të reciprocitetit ndaj Serbisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës, gjendja është duke shkuar drejt normalizimit. Qeveria e Kosovës do të punoj maksimalisht në bashkëpunim në kuadër të CEFTA-së duke dhënë kontributin e saj maksimal në heqjen e barrierave jo-tarifore dhe barrierave tarifore si dhe do të koncentrohet në monitorimin e zbatimit të termave që dalin nga kjo marrëveshje (Prioritetet 48, 55, 126 dhe 127).

b. Lëvizja e lirë e kapitalit

Plotësimi i kornizës ligjore (bazike) planifikohet të bëhet me Ligjin për Bankat, MFI dhe IFJB, Ligji për systemin e pagesave, Ligji për Sigurimet, Ligji për sistemin Pensional të Kosovës, kjo në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare si dhe me *Aquis Communautaire*, Këto ligje bazike planifikohet të plotësohen me kornizë shtesë ligjore sekondare.⁷ Fuqizimi i mbikëqyrjes së bazuar në risk do të bëhet me Manualin mbi Mbikëqyrjen bazuar në Rrezik (Sigurime), me anë të disajnit dhe implementimit të Softuerit për Mbikëqyrjen Financiare (banka, pensione, sigurime, IMF, IFJB) off-site. Avancimi i Mbikëqyrjes Financiare në pajtim me Standartet Basel II/III për Banka dhe Solvenca II për Sigurime, parasheh realizimin e një Kornize Analitike si dhe të një Plani të Veprimit për rishikimin dhe zhvillimin e rregullativës dhe praktikave mbikëqyrëse në pajtim me standardet e Basel II (banka) dhe Solvenca II (sigurime).

Me qëllim të sigurimit të zhvillimit të sistemeve ndërbankare bashkëkohore për ofrimin e shërbimeve bankare efektive për klientë, parashihet themelimi i sistemit për shlyerje individuale të pagesave në kohë reale, krijimi i një njësie bazuar në politikën dhe rregullat e vendosura për mbikëqyrjen e sistemit të pagesave në Kosovë, përmbajtja e zgjeruar e informacionit të RKK-së, si dhe automatizimi i procesit të inicimit të transaksioneve dhe marrjes së informacionit nga ana e klientëve të BQK-së. Sigurimi i zhvillimit të sistemeve ndërbankare bashkëkohore për ofrimin e shërbimeve bankare efektive për klientë, padyshim që implikon krijimin e “Electronic Trading Platform Software” (“Platforma elektronike e tregtimit të letrave me vlerë - Softueri”), si dhe Sistemi Depozitar Qendror i letrave me vlerë (CSD) i cili është në përgatitje e sipër (Prioriteti 56).

c. Doganat dhe tatimet

Doganat e Kosovës gjatë vitit 2011 kanë vazhduar me trendin pozitiv të mbledhjes së të hyrave, me rritje prej 18.4% në krahasim me vitin 2010. Gjithashtu edhe Administrata Tatimore e Kosovës gjatë vitit 2011 ka vazhduar me trendin pozitiv të mbledhjes së të hyrave ku ka realizuar rritje prej 19% në krahasim me vitin 2010.

⁷ Rregulloret (tani rregullat) për Bankat, MFI dhe IFJB, rregulloret për systemin e pagesave, rregulloret (tani rregullat) për Sigurimet, rregulloret (tani rregullat) për sistemin Pensional të Kosovës

Prandaj mund të konstatohet se Doganat dhe Administrata Tatimore kanë ngritur efikasitetin e tyre në mbledhjen e të hyrave. Në kuadër të politikave Tatimore, ATK gjatë vitit 2011 ka vazhduar me lëshimin e numrave fiskal për biznese dhe persona fizik si dhe pajisjen dhe instalimin e arkave fiskale për biznese, duke ndikuar në rritjen e trendit të të hyrave nga tatimet dhe në zvogëlimin e evazionit fiskal.

Për me tepër, për të plotësuar Kornizën Ligjore në këto dy institucione, është punuar në miratimin e legjislacionit bazik ku janë aprovuar tri ligje.⁸ Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve janë punësuar dhe trajnuar zyrtarë shtesë, që ka ndikuar në fuqizimin e mekanizmave për mbledhjen e të hyrave buxhetore dhe në koordinimin më të mirë të politikave për luftimin e krimit të organizuar, ekonomisë jo formale si dhe në zhvillimin e planeve të inkasimit të borxheve.

Përkundër të arriturave dhe masave shtesë të ndërmarra, sfida për këto institucione mbesin zbatimi i legjislacionit. Fushat specifike që kërkojnë vëmendje janë lufta kundër kontrabandës dhe falsifikimit si dhe kundër shkeljes se te drejtave mbi pronën intelektuale, ku poashtu është e nevojshme të bëhen përpjekje shtesë për të siguruar zbatimin efektiv të legjislacionit, zbatimin e pagesave tatimore dhe zvogëlimin e ekonomisë joformale.

Me qëllim të adresimit të këtyre sfidave të mbetura, Plani i tanishëm parasheh hapa të mëtutjeshëm në forcimin e legjislacionit primar dhe atij sekondar, si në fushën e Doganës po ashtu edhe në atë Tatimore, që do të ndikoj në implementimin më efektiv të politikave dhe strategjive për këto institucione. Po ashtu vëmendje e veçantë do të i kushtohet luftimit të shkeljeve të të drejtave mbi pronën intelektuale. Në këtë aspekt vëmendje e veçantë edhe këtë vit do t'i kushtohet ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe institucionale dhe bashkëpunimit me vendet tjera, sidomos në fushën e doganave. Kurse në fushën e tatimeve, përveç tjerash vëmendje e veçant do t'i kushtohet thellimit të bashkëpunimit me ATK-së dhe tatimpaguesve, duke funksionalizuar Qendrën për Thirrje si dhe mundësimin e deklaramit "online" të gjitha subjektet dhe të gjitha llojet e tatimeve.

Me qëllim të ngritjes së nivelit të shërbimeve të ofruara dhe përmirësimit të përpunimit të të dhënave si në Dogana ashtu edhe në Administratën Tatimore, prioritet do t'i jepet ngritjes dhe përmirësimit të teknologjisë informative. ATK-ja do të vazhdoj me lëshimin e numrave fiskal dhe funksionalizimin e arkave fiskale me qëllim të evitimit të evazionit fiskal dhe luftimit të ekonomisë jo formale e cila përbën një prioritet të veçantë për Qeverinë e Kosovës këtë vit (Prioritetet 57, 59, 128)

d. Konkurrenca

Autoritetit Kosovar i Konkurrencës (AKK) ka kompletuar kornizën ligjore me amandamentimin e Ligjit mbi Konkurrencën dhe ka vazhduar me hulumtimin e rasteve të shkeljes së konkurrencës lojale. KKK gjithashtu ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me vendet e rajonit, si dhe është bërë anëtar i Rrjetit Ndërkombëtar të Konkurrencës. Kjo sferë si prioritet ka sigurimin e një numri të mjaftueshëm të

⁸Projektligji për produktet e akcizës së duhanit në Kosovë, që zëvendëson Rreg 2003/23, Projektligji për ndalimin dhe kufizimin e importit të mallrave, Ligji për Lojrat e Fatit.

kuadrove të profilizuar për t'u angazhuar në kuadër të tri shtyllave kryesore të konkurrencës: kartelet, shfrytëzimi i pozitës dominuese dhe përqendrimet.

AKK planifikon që gjatë vitit 2012 të miratoj legjislacionin sekondar si: UA për "Kriteret dhe Kushtet për Përcaktimin e Marrëveshjes me Vlerë të Ulët ", UA për "Përcaktimin e Mënyrës së Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit", Projekt UA i hartuar për Formën dhe Përmbajtjen e Legjitimacionit", UA për "Përcaktimin e Kritereve për Lirimin nga Masat, Ndëshkimin, Zvogëlimin e Ndëshkimeve nga Neni 60/ Paragrafi 1 dhe 2 si dhe në pajtim me kriteret që dalin nga zbatimi i rregullave të Konkurrencës të BE-së". Ky institucion do të vazhdojë gjithashtu me hulumtimin e rasteve të reja të dyshuara për veprimtari antikonkurrencë (Prioriteti 55).

e. Prokurimi publik

Progresi i shënuar në kuadër të Prokurimit Publik konsiston në miratimin e Ligjit të ri për Prokurim Publik. Ligji i ri ka siguruar lirinë e zyrtareve të cilët merren me prokurimin publik, shkurtimin e të gjitha afateve të prokurimit dhe zvogëlimin e procedurave të prokurimit nga shtatë në gjashtë procedura. Ligji mbi Prokurimin Publik është thjeshtuar edhe duke transferuara disa funksione të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe MF-it tek Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRrPP). Ky ligj ka përcaktuar më qartë detyrat dhe raportet në mes të institucioneve qendrore të Prokurimit Publik në Kosovë siç janë: Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), Agjencia Qendror e Prokurimit (AQP) dhe Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP). Monitorimet e rregullta dhe sipas rastit do të jenë mënyra e mbikëqyrjes dhe e monitorimi i bazuar në Ligjin për Prokurim Publik. Për më shumë në këtë vit KRrPP ka paraparë përmirësimin dhe plotësimin e kuadrit të LPP-së me hartimin dhe miratimin e legjislacionit sekondar. Prioritet do të jenë rregullat mbi procedurat e prokurimit publik, kodi etik i prokurimit, udhëzuesit mbi procedurat e prokurimit, amandamentimi i udhëzuesit për kontratat kornizë, dispozitat ligjore që lidhen me zbatimin e koncesionit (të dala nga *acquis*) dhe po ashtu edhe Formularët standard për vlerësimin e tenderëve.

Plotësimi i stafit të OSHP-së sipas Ligjit të ri të Prokurimit Publik vazhdon të mbetet prioritet për këtë institucion. OSHP do të vazhdojë me shqyrtimin dhe trajtimin e ankesave të operatorëve ekonomik dhe autoriteteve kontraktuese si dhe do të ofroj të dhëna lidhur me numri i ankesave të shqyrtuara, përqindjen e ankesave të zgjidhura në favor të operatorëve ekonomik dhe në favor të autoriteteve kontraktuese, poashtu numrin e gjobave të shqiptuara ndaj autoriteteve kontraktuese.

Me qëllim të përpilimit të listave për prokurime qendrore dhe kontrata kornize, AQP do të punoj në pranimin e planifikimeve të prokurimit nga autoritetet kontraktuese. Në mënyrë që të adresohen sfidat, KRPP parasheh inicimin e një Memorandumi të mirëkuptimi në mes këtyre tre institucioneve të prokurimit me qëllim të koordinimit sa më të mirë të punëve (Prioritetet 61, 129).

f. Të drejtat e pronësisë intelektuale

Kjo fushë, përkundër progresit të arritur, ka qenë mjaft e kufizuar dhe ndikuara nga mungesa e ndjeshme e kapaciteteve njerëzore, pasi që Institucionet përgjegjëse për

rregullimin dhe avancimin e kësaj fushe kane mungese te dukshme te tij.. Zyra për Pronësi Industriale pranë MTI-së ka ngritur kapacitetet teknike të saj përmes rekrutimit të stafit të ri dhe njëkohësisht ka pasur edhe ngritje profesionale të stafit përmes një numri trajnimesh dhe vizitash studimore për stafin e institucioneve të përfshira në këtë fushë. Si produkt i Strategjisë për Pronësi Intelektuale 2010 -2014 dhe Planit të saj akcional është Këshilli Kombëtar për Pronësi Intelektuale. Këshilli përbëhet prej disa institucioneve qeveritare dhe joqeveritare të cilat do të ndihmojnë në implementimin e plotë të legjislacionit në mbrojtje të pronësisë intelektuale . Këshilli, pas funksionalizimit të tij, do të punoj në çështjen e shkatërrimit të produkteve të rrezikshme për shëndetin dhe rrethin, do të ndërmarr masat për ndëshkim pas shkeljes së te drejtës së pronësisë intelektuale, do të organizoj fushata sensibilizuese për opinionin lidhur me rendësin e mbrojtjes së pronësisë intelektuale, si dhe aktivitete kundër falsifikimit të produkteve. Gjithashtu do të vazhdohet me funksionalizimin e databazës për regjistrimin e lëndëve, me ç' rast do të azhurnohen rregullisht aplikacionet e reja nga ana e Zyrës për Pronësi Industriale. Memorandumi i bashkëpunimit Ndër-institucional është përgatitur dhe pritet të nënshkruhet nga ZPI, ZDAP, Doganat, Policia, Inspektorati i tregut, Prokuroria dhe Gjykata.

Ndërkaq, në sferën e bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë fushë janë nënshkruar marrëveshje me Zyrën e Pronësisë Industriale të Republikës së Kroacisë dhe Maqedonisë dhe do të procedohet me nënshkrimin e marrëveshjeve së bashkëpunimit me Shqipërinë dhe Malin e zi.

Pronësia intelektuale, përfshirë pronësinë industriale atë të drejtave të autorit dhe të drejtat tjera të përafërta, përkundër progresit të shënuar në disa sfera të saj, duhet të zhvillohet dhe rregullohet edhe më tej, sidomos në sferat e mbuluara nga institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e saj. Infrastruktura ligjore që rregullon këtë fushë, mbetet të plotësohet me legjislacion sekondar si dhe kërkohen aktivitete shtesë në implementimin e Strategjisë për Pronësi Intelektuale nëpërmes të Planit të Veprimit. Sfidë tjetër me rëndësi është edhe plotësimi i personelit profesional në institucionet përgjegjëse dhe/ose bashkëpërgjegjëse si dhe nevoja për ngritje profesionale të personelit ekzistues. Për më shumë, përballja me vëllimin e kërkesave për mbrojtje të objekteve të pronës industriale dhe aplikimi i mbrojtjes së paraparë me ligjet në fuqi, mbetet edhe më tutje sfidë për të gjitha institucionet e përfshira (për më shumë detaje shih tabelën e veprimeve, Prioritetet 62 dhe 130).

g. Punësimi dhe politikat sociale

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), gjatë vitit 2011 ka vazhduar me adresimin e sfidave të punësimit, përmes implementimit të Strategjisë së Punësimit me fokus tek te rinjtë, personat me aftësi të kufizuara, përfituesit e asistencës sociale dhe personat në varfëri. Ka vazhduar regjistrimi i punëkërkuësve përmes Shërbimit Publik të Punësimit, gjithashtu është bërë modernizimi i zyrave publike të punësimit. Inspektoret e Punës kanë filluar punën e tyre edhe në Komunën e Obiliqit, Shtërpcës dhe Graçanicës.

Programi dhe Plani i veprimit kundër dhunës në familje është aprovuar dhe ka vazhduar përfshirja aktive e . organizatave të shoqërisë civile në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe në implementimin e ligjit. Gjithashtu, është bere

progres në fushën e dialogut social⁹ ku edhe kanë filluar diskutimet në mes të partnereve social për vendosjen e nivelit të pagës minimale. Janë vendosur standardet minimale për pesë shërbime sociale¹⁰

Me gjithë progresin e shënuar, sfidë në sektorin e punësimit mbetet rishikimi i draft-dokumentit të Letrës së Bardhë për Politika Sociale si dhe krijimi i një formule për financimin e shërbimeve sociale dhe familjare e cila del si ndër prioritetet e MPMS-se për vitin në vijim. Sfidë tjetër është sigurimi i qëndrueshëm i kostos të Ligjit të Punës Si dhe aprovimi i Ligjit për Skemën e Asistencës Sociale dhe Ligjit për Shërbime Sociale Familjare. Hartimi dhe aprovimi i legjislacionit sekondar që do të bënte të mundur implantimin e Ligjeve bazike në fushën e punësimit dhe çështjeve sociale, do të jenë aktivitete prioritare që reflektohen në PVPE të vitit 2012 (për më shumë detaje shih tabelën e veprimeve, Prioritetet).

Aktivitete të MSH-së janë përqendruar në ofrimin e shërbimeve shëndetësore të gjitha komuniteteve minoritare, me prioritet komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas, ku janë realizuar fushata të vetëdijesimit mbi rreziqet shëndetësore të kontaminimit me plumb. Janë përgatitur raporte vlerësuese mbi shkallën e kontaminimit si dhe janë siguruar medikamente të mjaftueshme për trajtimin e personave me nivele të ngritur të plumbit në gjak. Gjithashtu është bërë përshtirja fëmijët nga ky komunitet në fushatën imunizimit dhe vaksinimit. Në kuadër të ngritjes e kapaciteteve institucionale në fushën e shërbimeve shëndetësore në vitin 2011 është funksionalizuar Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Stokut Farmaceutik. Moduli on-line i këtij sistemi është zbatuar në të gjitha institucionet shëndetësore publike në nivel të Republikës dhe është plotësisht funksional. Porositë për furnizim me barna nga lista esenciale nga të gjitha institucionet shëndetësore behet on-line.

Në kornizën ligjore dhe asaj të politikave në fushën e shërbimeve shëndetësore, me 05/08/2011 është miratuar Strategjia dhe Plani i Veprimit për Shëndetin e Nënës Fëmijës dhe Adolehentëve dhe shëndetit Riprodhues.

Objektivat kryesorë për vitin 2012 do të jenë adresimi i sfidave të dala nga Raporti i progresit 2011 dhe objektivat tjera të adresuara në PVPE 2012 që janë vazhdimësi e objektiveve të parashtruara në vitin 2011: ngritja e kapaciteteve institucionale në fushën e shërbimeve shëndetësore dhe përmirësimi i kornizës ligjore dhe asaj të politikave në fushën e shërbimeve shëndetësore.

h. Arsimit dhe kërkimet

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë ka vazhduar përkushtimin e saj për të zhvilluar një arsim gjithëpërfshirës duke ofruar mundësi të barabarta dhe arsimim cilësor. Miratimi i Ligjit për Arsimin Para-Universitar dhe Ligji për Arsimin e Lartë si dhe i Planit Strategjik i Arsimit në Kosovë (PSAK) 2011-2016 nga Qeveria e Kosovës, ka përmirësuar infrastrukturën ligjore në këtë lëmi, Çështja e mësimin në shumë ndërrime është adresuar përmes krijimit të infrastrukturës shkollore

⁹ Aprovimi i Ligjit për Sindikatat që rregullon mandatin e themelimit të tyre. Aprovimi i Ligjit të ri për Këshillin Ekonomik Social, Funksionalizimi i Këshillit Ekonomik Social.

¹⁰ Standardet: dhuna në familje; fëmijët në punë; adoptimi; besimi i fëmijëve; personat e moshuar në institucione.

adekuate, gjithënjë duke ju dhënë prioritet ndërtimit të shkollave aty ku siguria e nxënësve është rrezikuar si pasoje e objekteve shkollore të vjetra. Korniza Kombëtare e Kurrikulit të Kosovës është miratuar dhe pashtu ka filluar implementimi i kurrikulës së parë për gjuhën, historinë dhe kulturën Rome në disa pilot komuna të Kosovës. Me caktimin e personit kontaktues kombëtar për Kornizën e Programit Shtatë (FP7) dhe pas fushatave informuese, pritjet rritja e aplikacioneve nga Kosova në këtë program. Projekti i IPA-s "Përkrahje shkencës dhe hulumtimit në Kosovë" ka filluar së implementuari dhe përmes së cilit 1 milion euro do të ndahen për projekte hulumtuese në fushat me prioritet.

Me gjithë progresin e arritur, MASHT ende sfidohet në shumë fusha të saj. Cilësia e mësimin edhe më tutje mbetet një ndër sfidat kryesore në arsim. Infrastruktura ligjore duhet të plotësohet edhe në vitin 2012 përmes rishikimit dhe plotësimit të ligjeve të ndryshme. Ende ka shkolla që punojnë në tre ndërrime. Përkundër themelimit të Autoritetit Kombëtar të kualifikimeve dhe Këshillit për Arsim dhe Aftësim Profesional, ndërtimi i kapaciteteve të këtyre organeve duhet të përmirësohet më tej. Ngritja profesionale e mësimdhënësve të arsimit fillor dhe të mesëm është identifikuar si sfidë në Raportin e Progresit 2011. Për shkak të mospërbushjes së standardeve të akreditimit, programe në kuadër të Fakultetit të Edukimit nuk kanë arritur të akreditohen nga ana e Agjencisë Kosovare të Akreditimit. Fusha e shkencës dhe hulumtimit vazhdon të mbetet me kapacitete të vogla hulumtuese dhe me pjesëmarrje të ulët në programet e ndryshme Evropiane.

Plani i Veprimit të Integritimit Evropian i vitit 2012 synon që përmes veprimeve të ndryshme të adresoj sfidat e lartcekura, të cilat janë identifikuar edhe në Raportin e Progresit të vitit 2011. Do të bëhet rishikimi, plotësimi dhe miratimi i tre ligjeve në kuadër të fushës së përgjegjësisë së MASHT. Me qëllim të përmirësimit të cilësisë në arsim, gjithashtu parashihet themelimi i Agjencisë për Kurrikul, Monitorim dhe Vlerësim. Do të vazhdohet me projekte kapitale në komuna të ndryshme me qëllim të krijimit të kushteve adekuate për mësim dhe reduktimin e mësimin në shumë ndërrime. Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve Këshilli për Arsim dhe Aftësim Profesional do të shndërrohet në agjenci, si dhe do të realizohen trajnime dhe vizita të ndryshme për të si dhe për Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve. Në arsimin e lartë do të adresohet çështja e akreditimit të programeve në Fakultetin e Edukimit, si dhe do të synohet rritja e numrit të përfituesve nga programet e ndryshme për arsimin e lartë dhe projekteve të ndryshme shkencore përmes programeve CEEPUS, TEMPUS, ERASMUR. (për më shumë detaje shih tabelën e veprimeve, përkatësisht prioritetet numër 67-71, 132, 135).

3.3.2 POLITIKAT SEKTORIALE

a. Industria dhe NVM-të

Departamentit i Industrisë (DI) ka paraparë që në këtë vit të orientohet në trajnimin e stafit për rregullat teknike të infrastrukturës së cilësisë së produkteve. Sa i përket NVM-ve është punuar mjaft në përmirësimin e ambientit biznesor bazuar në Aktin Evropian të Bizneseve dhe në tetë indeksat e saj. Bazuar në këtë është miratuar Ligji për Shoqëritë Tregtare dhe është mundësuar regjistrimi i bizneseve *online*. Ndër të tjera është bërë inaugurimi i dy parqeve të biznesit si dhe po punohet në parqe të tjera. Tanimë është duke u punuar në Planin e Veprimit për implementimin e Strategjisë afatmesme të NVM-ve dhe koordinimin e kësaj strategjie me strategjitë

tjera që e afektojnë këtë fushë. Me rëndësi të veçante është edhe baza e të dhënave për biznese "online" e cila parasheh fshirjen nga kjo bazë të gjitha bizneseve jofunksionale. Inkurajimi i bizneseve në bazë të ofrimit të këshillimeve dhe trajnimeve si dhe marketingut për shfrytëzimin e plotë të Inkubatorëve të Biznesit (IB), në Shtime, Gjilan dhe Deçan me anë të realizimit të 30 voucherëve për ofrimin e trajnimeve, këshillimeve, marketingut për bizneset që do të vendosen në inkubatorë të biznesit në këto tre inkubatorë.

Gjithashtu është duke u finalizuar inkubatori i ri në kuadër të parkut të Biznesit në Drenas për krijimin e hapësirave të punës për biznese. Deri me tani, Tetëmbëdhjetë (18) hapësira të punës planifikohen të krijohen për vendosjen e bizneseve, si dhe do të hapet konkursi për vendosjen e bizneseve në IB. Sa u përket Vaucherëve, po ashtu janë paraparë tre mijë (3000) ditë trajnimesh/këshillimesh për bizneset ekzistuese dhe ndërmarrësit potencial, si dhe parashihet që të organizohet një konkurs i hapur për akreditimin e Këshilltarëve dhe Trajnerëve për SVKT dhe se deri më tani ka pasur 32 aplikime për këshiltar dhe trajner të rinj. Në nivel të përgjithshëm mendohet të behet vlerësimi dhe ngritja e vetëdijes për NVM-të nëpërmes të publikimeve dhe hulumtimeve për NVM-t, anketimit dhe observimit, nxjerrjes së rekomandimeve dhe me anë të Internship -biznesi për studentë në kompanitë vendore.

Agjencia Kosovare për Promovimin e Investimeve (APIK) ka arritur që të rrisë kapacitetet njerëzore si dhe ka krijuar bazën e të dhënave me qëllim të identifikimit të pronave të cilat mund të ofrohen për investitorët e huaj dhe të identifikimit e këtyre të fundit. APIK ka paraparë që nga Evaluimi i Raportit të Bankes Botrore (Doing Bussiness) të themelohet një Grup Nderministror për Reforma në Ambijentin e Biznesit si dhe të përpilohet një dokument analitik dhe unifikues me rekomandim për krijimin e një klime më të mirë Investive në Kosovë. Në të ardhmen planifikohet që të adresohen të gjeturat nga evoluimet e bëra nga OECD-ja dhe BB me qëllim të krijimit të parakushteve për ambient më të mirë investiv. APIK parasheh të punoj në hartimin e dokumenteve që do të paraqiten si rekomandime për Qeverinë së Kosovës për ndihmesën në krijimin e një klime më të mirë investive. Me qëllim të ngritjes së performancës së personelit të APIK- ut, ky do të duhej certifikuar ata sipas standardeve, si dhe do të duhej forcuar bashkëpunimi me agjencitë e vendeve anëtarë të BE-së me qëllim të shkëmbimit të përvojave. Në të ardhmen do të punohet në ofrimin e përkrahjes për prodhues vendor me mundësimin e ekspozimit të produkteve të tyre në panairë ndërkombëtare.

Themelimi i qendrave komunale për regjistrimin e bizneseve "one stop shop" në 14 komuna në mënyrë që të bëhet lehtësimi i regjistrimit të bizneseve në Kosovë do të jenë sfide për këtë vit. Gjithashtu, në drejtim të realizimit të këtij projekti do të bëhet aftësimi i sistemit adekuat të TI-së (Prioritetet 55, 72, dhe 125).

b. Bujqësia dhe peshkataria

Zhvillimi i qëndrueshëm bujqësor dhe rural do të jetë në fokus të veçantë për institucionet tona, kjo në përpjekje të vazhduar për përmirësimin e kualitetit të jetesës dhe atë përmes promovimit të bujqësisë intensive dhe aktiviteteve të tjera ekonomike dhe rurale, posaçërisht në diversifikimin e aktiviteteve rurale.

Gjatë vitit 2011 MBPZHR është angazhuar në krijimin e legjislacionit të ri dhe amandamentimin e atyre ekzistuese. Përkundër angazhimeve maksimale gjatë kësaj

periudhe, janë shënuar edhe mangësi në miratimin e projektligjeve të reja dhe amandamentimin e atyre ekzistuese.¹¹ Sa i përket ruajtjes dhe shfrytëzimit të tokës bujqësore, është hartuar dhe miratuar Strategjia e Konsolidimit të Tokave Bujqësore (29.06.20110). Në sferën e rregullimit të gjuetisë, MBPZHR ka dhënë tri pëlqime për krijimin e vendeve të gjuetive të përbashkëta në komunën e Gjilanit.

Sektori i bujqësisë gradualisht është duke u përmirësuar përmes krijimit të politikave dhe legjislacionit me të favorshëm. Janë ngritur të ardhurat nga fermat si dhe janë bërë përmirësime në përpunim dhe tregtim të produkteve bujqësore duke promovuar prodhimet me vlerë të lartë ushqyese. Më tej janë implementuar skemat mbështetëse, përmes pagesave direkte/subvencioneve për fermerët në sektorin e bujqësisë, blegtorisë dhe hortikulturës dhe janë ngritur kapacitetet e fermerëve në përdorimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe përdorimin e preparateve kimike.

Përkundër progresit të arritur, gjatë vitit 2011, sfidë në sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë mbetet mbrojtja e tokës bujqësore dhe tokës pyjore nga ndërrimi i destinimit të tyre si dhe nga shfrytëzimi i gurorëve dhe zhavorrit në kundërshtim me ligjin në fuqi. Mund të konstatohet se ky fenomen shfaqet si pasojë e mos koordinimit adekuat në mes të institucioneve qendrore/lokale dhe gjykatave.

Zhvillimi i sektorit të bujqësisë si njëri nga prioritetet e Qeverisë, do të ketë trajtim të veçantë me qëllim të rritjes së prodhimit, zvogëlimit të importit të produkteve bujqësore dhe njëherit rritjes së punësimit. Duke pasur parasysh rëndësinë e sektorit, MBPZHR dhe donatorët do të ofrojnë subvencione dhe grande, përmes skemave mbështetëse bazuar në PZHRB 2009-2013.

Objektiv kryesor në fushën e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural do të jetë plotësimi i kornizës ligjore bazike dhe përafrimit të legjislacionit ekzistues me *acquis communautaire*, si dhe plotësimi i legjislacionit sekondar në harmoni me rregulloret e BE-së. Po ashtu do të zhvillohen politika për reformën e qëndrueshme të tokës, pasiqë humbjet e mëtutjeshme e tokave bujqësore (ndërrimi i destinimit) është kërcënimi serioz për të ardhmen e Kosovës. Me qëllim të ngritjes së të ardhurave nga fermat, do të rehabilitohen sistemet e ujitjes (kanalet primare dhe sekondare) sistemit informimit të tokave të ndotura, informacionit të thjeshtëzuar të parcelave, themelimit të regjistrit të fermave si dhe ofrimi i shërbimeve këshillimore dhe trajnimet e fermerëve në fushën e bujqësisë dhe pylltarisë.

Në fushën e pylltarisë, do të ndërmerren veprime në hartimin e programit për pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura, zhvillimit të gjuetisë, identifikimin dhe sanimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve. Në zbatim të procesit të decentralizimit të kompetencave të menaxhimit të pyjeve, dhe tokave pyjore, MBPZHR së bashku me kuvendet komunale, do të sigurojë që pyjet dhe tokat pyjore në Kosovë të menaxhohen në pajtueshmëri me principet dhe praktikat evropiane të menaxhimit dhe mbrojtjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm të të gjitha llojeve të pyjeve. Kjo do të përfshijë principet parandaluese, principet e barazisë ndërmjet gjeneratave, konservimin e biodiversitetit dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekologjik. Veprime dhe aktivitete të rëndësishme do të jenë monitorimi i vazhdueshëm i resurseve pyjore për të siguruar një shfrytëzim të qëndrueshëm të pyjeve, ofrim të resurseve adekuate

¹¹ Është miratuar Ligji për Verëra (27.07.2011)

për institucionet qeveritare përgjegjëse për pylltari si dhe freskimi i kornizës rregullative që do t'i reflektonte ndryshimet dhe trendët zhvillimore në shoqëri.

Prandaj, veprimet dhe aktivitetet kryesore të kësaj fushe të cilat adresohen përmes PVPE 2012 janë: hartimi i legjislacionit primar dhe atij sekondar, forcimi i shërbimeve këshillimore, ngritja e kapaciteteve institucionale, përmirësimi i qasjes në kredi të leverdishme sepse ofrimi i kredive nga ana e Bankave Komerciale janë akoma të pa favorshme për zhvillimin e fermave dhe agrobiznesit në përgjithësi, shfrytëzimi i qëndrueshëm i tokave dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i pyjeve. Me PVPE 2012, synohet të arrihen disa objektiva duke ristrukturuar sektorin agro-rural në linjë me atë të BE-së.

Siguria e ushqimit dhe veterinaria

Bazuar në Raportin e Progresit të KE 2011, mbeten ende sfida të cilat duhet të adresohen në të ardhmen. Përkundër që me Ligjin e Ushqimit janë sqaruar kompetencat në mes të nivelit qendror dhe atij komunal, Transferimi i inspektorëve (veterinar, fitosanitar dhe sanitar) nën ombrellën e AUVK ka ngecur ndjeshëm. Gjatë vitit 2011, azhurnimi i bazës së të dhënave për lëvizjen e kafshëve dhe identifikimit, regjistrimit dhe kontrollit të tyre, ka vazhduar me dinamikën e paraparë. Në vitin 2012 janë paraparë veprime për funksionalizimin e një sistemi me të avancuar të identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve (ruminantëve të vegjël).

Sa i përket avancimit të ndërmarrjeve ushqimore, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ka organizuar takime informuese me të gjitha ndërmarrjet agro-përpunuese rreth procesit të kushteve të licencimit të depove ftohëse sipas standardeve evropiane (kategorizimit të depove të tyre), varësisht prej kushteve të objekteve dhe procedurave të aplikuara për garantimin e sigurisë së ushqimit.

Me qëllim të adresimit të sfidave në sferën e sigurisë së ushqimit dhe me qëllim të përmirësimit të gjendjes së këtij sektori, AUVK ka paraparë një mori veprimesh në fushën e sigurisë së ushqimit në kuadër të PVPE 2012 si hartimi dhe miratimi i legjislacionit sekondar, transferimi i të gjithë inspektorëve nën ombrellën e AUVK, rritja e stafit dhe ngritja e kapaciteteve, operacionalizimi i plotë i Infrastrukturës së TI-së për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve, rritja e kontrollit të lëvizjes së kafshëve, avancimi i mëtejshëm i ndërmarrjeve agroushqimore dhe funksionalizimit të mëtejshëm të Laboratorit të Ushqimit.

c. Mjedisit

Sektori i mjedisit ka vazhduar të plotësojë bazën ligjore përmes së cilës funksionon, duke plotësuar atë përmes legjislacionit sekondarë. Miratimi i udhëzimeve administrative¹² e mundëson përmirësimin e kornizës ligjore për implementim të legjislacionit nacional në harmoni me standardet evropiane. Përmes themelimit të

¹² Udhëzimi Nr.02/2011 për Administrimin e mbeturinave nga gypat fluoreshent që përmbajnë merkur; Nr.03/2011 për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e plotësimit të aplikacionit për leje të integruar; Rregullorja Nr.04/2011, për mënyrën e llogaritjes së pagesës për kontrollin teknik të objekteve ndërtimore,

Agjencinë për siguri Nukleare dhe Mbrojtje nga Rrezatimi, është shënuar progres drejt përforcimit të strukturave operative në sektorin e mjedisit.

Për më tepër, MMPH ka vazhduar zbatimin e projekteve për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik duke kompletuar rrjetin për monitorimin e cilësisë së ajrit; ndërtimin e impianteve për sterilizimin e mbeturinave infektive duke pajisur ato me pajisje për sterilizimin e mbeturinave infektive, etj. Në anën tjetër, gjatë vitit 2011 është shënuar progres në fuqizimin e inspektoratit mjedisor.

Me gjithë progresin e shënuar, sektori i mjedisit përballet me sfida sidomos në zbatimin e legjislacionit mjedisor i cili ende mbetet problematik. Përpjekje të mëtejme janë të nevojshme për të themeluar një infrastrukturë administrative dhe institucionale efektive dhe për të përmirësuar kanalet e bashkërendimit mes institucioneve me përgjegjësi mjedisore në të gjitha nivelet dhe me shoqërinë civile. Për më tepër, sektori i mjedisit si sfidë për adresimin e problemeve mjedisore ka para vetës ngritjen e kapaciteteve njerëzore.

Në përpjekje të adresimit të këtyre sfidave, ky Plan parasheh të ndërmerren masa për përmirësimin e kornizës legjislative në fushën e mjedisit, hartimin e politikave/strategjive në pajtim me prioritetet nacionale dhe standardet evropiane dhe ngritjen e kapacitetet njerëzore. Si rezultat, nga ky Plan pritet forcimi i rolit të institucioneve përgjegjëse për implementimin sa më efikas të legjislacionit mjedisor përmes një bashkëpunimi më të ngushtë institucional për adresimin e sfidave në sektorin e mjedisit si dhe përafrimin me *acquis communautaire* (Prioritetet 53, 78, 79, 140, 141, 142).

d. Politikat e transportit

Një ndër prioritetet më të rëndësishme për Qeverinë e Kosovës vazhdon të mbetet sektori i transportit, veçanërisht transporti rrugor. Projekti i R7 është duke u realizuar sipas dinamikës së paraparë. Përveç kësaj, punimet me intensitet të lartë kanë vazhduar në përmirësimin e përgjithshëm të infrastrukturës rrugore dhe mirëmbajtjes së asaj ekzistuese. Në fushën e rrjeteve trans-evropiane, Kosova ka vazhduar të marrë pjesë aktive në implementimin e memorandumit të mirëkuptimit për zhvillimin e rrjetit kryesor rajonal të transportit në Evropën Juglindore. Sa i përket implementimit të ligjit mbi transportin e mallrave të rrezikshme, është dhënë autorizim për certifikim e automjeteve dhe pritet fillimi i certifikimit të mjeteve të transportit të mallrave të rrezikshme. Sa i përket implementimit të ligjit mbi transportin rrugor është miratuar Udhëzimit Administrativ për licencim e operatorëve të transportit rrugor të mallrave. Në vazhdën e përpjekjeve të përmirësimit të sigurisë rrugore është duke u hartuar Strategjia për Siguri Rrugore si dhe janë organizuar fushata për vetëdijësimin e shoferëve dhe nxënësve për sigurinë rrugore. Poashtu ka përfunduar me sukses procesi i aftësimin dhe testimin të kandidatëve për inspektues të automjeteve për kontrollim si dhe aftësimi për pyetës (examiner). Më tutje, MI është duke punuar me EGIS INTERNATIONAL në përmirësimin dhe azhurnimin e strategjisë multimodale si dhe përmirësimin e shërbimeve multimodale.

Sa i përket progresit në sektorin e hekurudhave, përkatësisht në fushën e legjislacionit primar, është miratuar ligji hekurudhat e Kosovës. Poashtu, është

realizuar ndarja e Hekurudhave të Kosovës në Infrastrukturë të Hekurudhave të Kosovës (Infrakos) dhe Operator të Trenave (Trainkos), ndërkaq procesi i ndarjes operative dhe financiare pritet të kompletohet gjatë vitit të ardhshëm. Sa i përket ngritjes së kapaciteteve institucionale, Autoriteti Rregullativ Hekurudhor (ARH) është konsoliduar dhe tani pritet të përfundojë edhe krijimi i rregullativës për licencimin e operatorëve hekurudhorë.. Projekti për studimin e fizibilitetit të linjës hekurudhore lindje perëndim do të financohet përmes Kornizës për Investime në Ballkanin Perëndimor (WBIF)./

Transporti ajror ka shënuar progres të konsiderueshëm, veçanërisht në implementimin e legjislacionit nacional sa i përket rregulloreve ekonomik dhe fushave tjera që kërkohen në fazën e parë të Marrëveshjes evropiane për zonën e përbashkët të aviacionit (ECAA). Po ashtu janë miratuar disa ligje që kërkohen në fazën e dytë. Pas analizës për kapacitete, Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës nga korriku është riklasifikuar si "Aeroport me skemë lehtësuese të orareve".

Përveç zhvillimeve pozitive të realizuara në sektorin e transportit gjatë vitit 2011, është më se e qarte se sfida për Qeverinë e Kosovës do të jetë gjetja e burimeve alternative financiare për vazhdimin e ndërtimit të R7 e që do të mundësonte investime në fushat tjera të zhvillimit ekonomik, duke përfshirë edhe mirëmbajtjen e rrugëve ekzistuese. Për më tepër, vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet zhvillimit të strategjive dhe politikave të transportit si dhe ndërmarrjes së hapave konkret për përmirësimin e sigurisë rrugore. Hekurudhat e Kosovës ende përballen me nevojën e ngritjes së kapaciteteve profesionale, rritjes së pavarësisë menaxheriale si dhe rritjen e buxhetit. Për më tepër, ky Plan parasheh aktivitete konkrete për adresimin e sidave të lartpërmendura. Qeveria e Kosovës do të vazhdojë me realizimin e projektit R7¹³ si dhe me përmirësimin e gjithëmbarshtëm në mirëmbajtjen dhe rehabilitimit të infrastrukturës rrugore. Në frymën e vazhimit të aktiviteteve për arritjen e marrëveshjeve bilaterale mbi transportin e udhëtareve dhe mallrave kanë filluar iniciativat me Kroacinë, Austrinë, Gjermaninë, Italinë dhe me Bullgarinë. Ndërkaq, me miratimin e ligjit për ndihmën shtetërore do të mundësohet edhe fillimi i implementimit të fazës së parë kalimtare të Marrëveshjes Evropiane për një Zonë të Përbashkët të Aviacionit (ECAA) (Prioritetet 49, 53, 81-84, 86, 89 dhe 143-145)

e. Energjia

Qeveria e Kosovës vazhdon me plotësimin e legjislacionit dhe zhvillimin e sektorit të energjisë, gjithnjë në përputhje me *acquis* të BE-së dhe kriteret e dala nga Traktati i Komunitetit të Energjisë (TKE). Angazhimi intensiv i autoriteteve dhe institucioneve relevante ka dhënë progres në arritjen e të lartpërmendurave, siç është Ligji për Eficiencë të Energjisë, finalizimi dhe miratimi i Strategjisë për Ngrohje 2011-2018, përfundimi i studimit të fizibilitetit për ngrohjen e Prishtinës, përmes Termokos me kogjenerim nga Termocentrali Kosova B, si dhe përmirësimi i matjeve të energjisë elektrike .

Njëra nga prioritetet e Qeverisë së Kosovës është dhe mbetet ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese, Termocentrali Kosova e Re. Duke konsideruar që ndërtimi i kapaciteteve kërkon kohë të konsiderueshme, për energjinë në dispozicion Qeveria e

¹³ Gjatë vitit 2011 kanë përfunduar segmentet 1-3 (Vermicë- Suharekë 38 km)

Kosovës ka marrë masa drejt kursimit të energjisë, eficiencën e energjisë si dhe pjesëmarrjen e burimeve të ripërtërishme të energjisë (BRE) në konsumin final të energjisë.

Sfidë e vazhdueshme, edhe pse me përmirësime të vogla, mbetet shkalla e pakënaqshme e gjenerimit, faturimit dhe e inkasimit të energjisë elektrike së bashku me humbjet teknike dhe komerciale të energjisë elektrike.

Pengesa e drejtpërdrejtë që bëhet nga Operatori Serb i Transmisionit (EMS) duke lënë jashtë Operatorin Kosovar të Sistemit, Tregut dhe Transmisionit nga mekanizmat rajonal komercial mbetet sfidë për Kosovën. Për këtë, si njëra nga dispozitat lidhur me implementimin e provizioneve të Menaxhimit të Kongjestionit dhe Kompensimit të Transitit, është bërë Ankesë në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë (SKE) kundër Serbisë si palë kontraktuese. Përderisa ekziston ky diskriminim, kompensimet dhe humbjet e tilla zbatohen tek konsumatorët.

Veprimet e adresuara në këtë Plan janë në përputhje me kërkesat nga TKE-ja, Raportet e Progresit si dhe takimet Sektoriale për Dialogun për Satbilizim Asociim (DPSA), duke i bërë ato objektiva të Qeverisë së Kosovës. Këto obligime dhe angazhime përfshijnë sigurimin me furnizim të qëndrueshëm me energji, integrimi në tregun rajonal, instalimi me kohë i kapaciteteve të reja, apo trajtimi eficient i energjisë në dispozicion. Për t'u arritur këto objektiva, janë vendosur një sërë veprimesh të matshme që pasqyrojnë përkushtimin e institucioneve përkatëse në sigurimin e prodhimit të energjisë; rritjen e faturimit dhe inkasimit; zhvillimin e infrastrukturës dhe legjislacionit për kapacitetet e reja në të ardhmen si dhe ato ekzistuese; zhvillimin e tregut të energjisë; ngritjen, zgjerimin dhe zhvillimin e kapaciteteve transmetuese e të gjitha niveleve (Prioritetet 87, 88, 146 dhe 147).

f. Shoqëria informative dhe mediat

Miratimi i rregulloreve implementuese ¹⁴nga ana e ART, ngritja e numrit të personeli profesional në ART, punësimi i Menaxherit për ccTLD si dhe Menaxheri për KOSIX tregojnë për një progres në sektorin e telekomunikacionit. KPM është duke zhvilluar Strategjinë e digjitalizimi që do të bënte të mundur kalimin nga transmetimi analog në transmetim digjital, proces i detyrueshëm për Republikën e Kosovës e në harmoni me marrëveshjet ndërkombëtare në fuqi.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale të ART-së dhe fuqizimit të pavarësisë operacionale të këtij rregullatori, paraqitet nevoja për rekrutim të ri të personelit. Po ashtu pritjet të rishikohen Politikat e sektorit të telekomunikacionit. Miratimi i Ligjit për RTK-në i cili do të forcoj pavarësinë e transmetuesit publik dhe të zgjidh përfundimisht çështjen qëndrueshmërisë financiare, pritjet që të përmbillet gjatë 2012.

¹⁴ Rregulloren për analiza të tregut dhe përcaktimin e ofruesve me fuqi të ndjeshme në treg, rregulloren për bashkë-shfrytëzim të plotë dhe të përbashkët të nyjës lokale dhe rregullorja për sigurimin e qasjes dhe interkoneksionit

g. Kontrolli financiar

Gjatë vitit 2011, Qeveria e Kosovës, ka vazhduar me përforcimin e mekanizmave institucional dhe ligjor që të forcojnë kontrollin financiar. Në fushën e kontrollit të brendshëm të financave publike (KBFP) është punuar në plotësimin e legjislacionit sekondar për të mbështetur zbatimin e Ligjit për Auditim të Brendshëm. Poashtu në aspektin e krijimit të politikave janë aprovuar një numër i procedurave që kanë lehtësuar kontrollin më të mirë të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin në bazë të decentralizimit të përgjegjësive të menaxhimit financiar nëpër organizatat buxhetore. Në kuadër të auditimit të jashtëm, institucionet e vendit kanë miratuar mjete të reja operacionale, me synim të vendosjes së një dialogu më të mirë me organet e auditimit. Zbatimi i rekomandimeve të auditimit të jashtëm nga organizatat buxhetore është përmirësuar, duke iu falënderuar pjesërisht bashkëpunimit më të mirë me Komisionin Parlamentar për mbikëqyrjen e menaxhimit të financave publike dhe bashkëpunimit me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm. Poashtu, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka rifreskuar Strategjinë e Zhvillimit të Përbashkët për vitin 2011.

Përkundër ndërmarrjes të një numër i konsiderueshëm masash, sfida për këtë sektor mbetet zhvillimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, duke e ngritur vetëdijen për politikën e saj të KBFP dhe duke filluar përmirësimin e cilësisë së auditimit të brendshëm si një mjet këshillues dhe i dobishëm për menaxhmentin. Sfidë e vitit 2012 është implementimi praktik i legjislacionit ekzistues. Duke ju referuar Raportit të Progresit 2011, zhvillimi i auditimit të jashtëm është në rrugën e duhur.

Me qëllim të adresimit të këtyre sfidave të mbetura, përmes këtij Plani i parashihen hapa të mëtutjeshëm në zbatimin e legjislacionit bazik dhe atij sekondar, si në fushën e kontrollit të brendshëm të financave publike, poashtu edhe në atë të auditimit të jashtëm. Për më shumë, do të ketë përpjeke për të zhvilluar dhe zbatuar parimet e përgjegjësive së decentralizuar të menaxhimit dhe funksionalitetit, auditimit të brendshëm të pavarur në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mira të BE-së.

Gjithashtu në sferën e auditimit të brendshëm ngritja e kapaciteteve në auditimin e brendshëm përmes trajnimit të trajnerëve për vazhdimin e programit për Çertifikim. Në drejtim të nxitjes së investimeve të jashtme dhe të përmirësimit të menaxhimit të aseteve, gjatë vitit 2012, do të jetë krijimi i mundësive më të mira për partneritetet publiko-private duke siguruar kompatibilitet me kornizën legjislative të BE-së mbi koncesionet.

Plani 2012, parasheh forcimin e kapaciteteve operative si dhe pavarësimin financiar dhe operacional të ZAP-së, duke ngritur kapacitetet administrative dhe njerëzore si dhe forcimin e legjislacionit dhe mundësimin e bashkëpunimit me organizatat tjera ndërkombëtare (Prioritetet 83, 92, 149,150)

h. Statistikat

Pas realizimit të Regjistrimit 2011, "Cenzusi", rezultatet finale priten në shtator të vitit 2012. Gjatë vitit 2012 pritet aprovimi i Ligjit për "Cenzusin" e Bujqësisë e kjo me

qëllim të kompletimin e kornizës ligjore e cila paraprihet nga Ligji për Statistikat dhe Ligji për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave tanimë të aprovuar. (Prioriteti 94).

3.3.3. DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA

a. Vizat, kufijtë, azili dhe migrimi

Gjatë vitit 2011 u miratua Ligji për Gjendjen Civile dhe Qeveria formoi një Grup Punues për hartimin e Politikës së Regjimit të Vizave. Gjithashtu, gjatë këtij viti përfundoi procesi i skanimit të regjistrave civilë dhe po vazhdon procesi i digjitalizimit të tyre. Për më shumë, ka filluar edhe procesi i lëshimit të pasaportave biometrik, parakusht tjetër për procesin e liberalizimit të vizave.

Progres është shënuar edhe në fushën e menaxhimit të kufijve, përmes instalimit të sistemit BMS nëpër të gjitha pikat kufitare. Gjithashtu, ka përfunduar transferi i kontrollit të kufirit me Maqedoninë nga KFOR në KP, përderisa janë nënshkruar edhe një numër marrëveshjesh për bashkëpunim ndër-kufitar me shtetet fqinje.

Sa i përket politikave të migracionit, Kosova ka shënuar progres sidomos sa i përket procesit të riatdhesimit dhe ri-integrimit, përmes nënshkrimit të një numri marrëveshjesh për riatdhesim me shtete anëtare të Schengen. Për më tepër, Fondit për Ri-integrim i janë ndarë rreth 3.4 milionë euro por edhe i janë shumëfishuar numri i kërkesave për përfitim nga ky fond. Gjithashtu, komunikimi me nivelin lokal është përmirësuar dhe janë trajnuar ZKKK-të për ri-integrimin e personave të riatdhesuar, me ç'rast edhe janë miratuar përkrahjet e vendeve të punës dhe termat e referencës për këto zyra.

Megjithatë, nevojitet ende progres në këto fusha, sidomos sa i përket sigurimit të implementimit të legjislacionit dhe politikave për menaxhim të kufijve dhe për regjim të vizave. Për më tepër, duhen edhe më tutje përpjekje për forcimin e procesit të ri-integrimit të personave të riatdhesuar, sidomos sa i përket zhvillimit të një sistemi të menaxhimit të lëndëve, thjeshtëzimit të procedurave për përfitim nga Fondi për Ri-integrim dhe asistimin e të riatdhesuarve për qasje në tregun e punës.

Për të adresuar këto sfida, Plani 2012 parasheh masa që do të përqendrohen në çështjet kufitare, sigurinë e dokumenteve dhe zbatimin e politikës së vizave, e cila gjithashtu do të vendoset gjatë këtij viti. Në këtë kontekst, PVPE 2012 parasheh ndërhyrje strategjike në nivelin e dokumenteve të politikave dhe planeve operacionale. Përveç kësaj, masat përkatëse gjithashtu synojnë ngritjen e kapaciteteve institucionale përmes investimeve kapitale, rekrutimeve shtesë (përfshirë transferimet e brendshme) e trajnimeve, me prioritet riatdhesimin dhe ri-integrimin e personave të riatdhesuar, çështjet kufitare dhe sigurinë e dokumenteve (Prioritetet 95, 96)

b. Shpëlarja e parave

Në fushën e parandalimit të shpëlarjes së parave, transferi i përgjegjësisë nga EULEX në NJIF është në proces e sipër. Për më tepër, është caktuar Drejtori i NJIF dhe është në proces e sipër funksionalizimi i plotë i këtij njësi. Gjithashtu, mbështetje këtij njësi po i ofrohet edhe nga Policia e Kosovës (Departamenti për Krime Ekonomike dhe Korrupsion) dhe Task Forca për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike (udhëhequr nga Prokuroria Speciale, ku marrin pjesë EULEX dhe PK).

Përkundër progresit në këtë fushë, dy institucionet ekzekutive përgjegjëse akoma nuk janë funksionale, kurse kapacitetet e institucioneve ekzistuese mbeten mjaft të kufizuara, në veçanti sa i përket përndjekjes penale. Përveç kësaj, probleme ka në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, kurse sa i përket zbatimit akoma mungon një sistem gjithëpërfshirës i monitorimit të transaksioneve bankare të subjekteve fizike e juridike publike e private (përfshirë OJQ-të), i cili ka rëndësi kyçe sidomos për parandalimin dhe hetimin e këtij lloji krimi.

Me qëllim të adresimit të këtyre sfidave, PVPE 2012 parasheh një sërë ndërhyrjesh strategjike që reflektojnë prioritetin që i japin autoriteteve vendore kompletimit dhe avancimit të mëtejshëm të kornizës ligjore, rregullative dhe asaj të politikave. Më tej, me rritjen e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve është bërë e mundur që gjyqësori të fokusohet në specializimin e një numri syresh në këtë fushë. Poashtu sa i përket ekzekutivit, agjencitë relevante të zbatimit të ligjeve kanë paraparë ngritjen e kapaciteteve të tyre institucionale përmes rekrutimeve, trajnimeve, si dhe avancimit të infrastrukturës së nevojshme teknike (Prioriteti 99).

c. Drogat

Në fushën e luftës kundër narkotikëve, Policia ndjeshëm ka rritur numrin e operacioneve dhe hetimeve, që ka rezultuar me numër më të lartë të arrestimeve dhe shkatërrimin e grupeve kriminale të përfshira në të tilla aktivitete kriminale. Shkëmbimi i informacioneve me Shqipërinë dhe Maqedoninë ka shënuar përmirësime, përderisa është rekrutuar personel shtesë në Drejtorinë për Luftimin e Trafikimit me Narkotikë në PK.

Me qëllim të adresimit të këtyre sfidave, PVPE 2012 parasheh ndërhyrje strategjike në avancimin e kornizës ligjore dhe zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve institucionale për luftimin e drogave, me fokus në luftimin e trafikimit të tyre, përmes rekrutimeve, trajnimeve, si dhe avancimit të infrastrukturës së nevojshme teknike, si të agjencive ekzekutive të zbatimit të ligjit ashtu edhe të institucioneve gjyqësore.

d. Policia

Gjatë vitit 2011, përmes miratimit të strukturës së re organizative dhe miratimit të Planit për Teknologjinë Informativë është shënuar progres në kompletimin e kornizës administrative për policinë. Për më tepër, miratimi i Ligjit për Inspektoratin e Policisë në masë të madhe ka ndihmuar në kompletimin e kornizës ligjore për policinë.

Gjithashtu, Policia ka themeluar Njësitin për Koordinim të Zbatimit të Ligjit (ILECU) dhe ka vazhduar bashkëpunimin me EULEX.

Me gjithë progresin e shënuar, para Policisë dhe MPB mbeten një numër sfidash, sidomos për sa i përket përmirësimit të mëtejshëm të kapacitetit të PK për luftimin e krimit të organizuar bazuar në konceptin e 'policisë së udhëhequr nga inteligjenca', si dhe luajtjes së një roli më proaktiv kundër krimit. Gjithashtu, mbetet një numër sfidash në kuadër të kapacitetit të brendshëm administrativ si dhe në drejtim të menaxhimit të procesit të vështirë të ristrukturimit. Problem shtesë për PK-në mbeten edhe rrethanat politike që pamundësojnë bashkëpunimin direkt me agjencitë ndërkombëtare pa u mbështetur në EULEX-in.

